



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 13.05.2016, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Vazhdimi i diskutimit për shqyrtimin nen për nen të Projekt Amendamenteve Kushtetuese, për grupin e II-të të dispozitave, pjesa e Gjykatës Kushtetuese (nenet 14-24).

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Arben Ristani, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Jorida Tabaku, Petrit Vasili.

**Mungon:**

Eduard Halimi, Spartak Braho,

**Të ftuar:**

Rainer Deville – shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert – përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Fillojmë mbledhjen.

Ju kërkoj ndjesë për vonesën gjysmë subjektive, gjysmë objektive, por për shkak të një *event*-i tjetër, që është duke u zhvilluar, sepse ndërkohë që ne jemi këtu duke diskutuar për projektin kushtetues, grupi i konsultimit për shtyllën e edukimit ligjor është duke bërë një konsultë për projektligjet e fushës së tij, nga ana tjetër grupi për reformën në drejtësinë penale është duke bërë një konsultim të gjerë me prokurorë dhe gjyqtarë për ligjet që lidhen me prokurorinë, SPAK-un dhe çështje të tjera.

Kështu që sot në të gjitha katet e Parlamentit kemi nga një *event* që lidhet me reformën në drejtësi. Kjo ishte edhe arsyeja pse u vonuam paksa, por mund të fillojmë tani me pjesën që lidhet me Gjykatën Kushtetuese, me nenin 14 që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 124 fillimisht.

Ka pyetje ose komente për nenin 124 të Kushtetutës aktuale? Nuk ka.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, mundem të them diçka?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Oerd Bylykbashi** – Sigurisht që ky është neni i parë i kësaj pakete dhe shqetësimi im kam përshtypjen se është i zgjidhur më pas, por duhet të jetë e qartë që ne në këtë kapitull duhet të zgjidhim çështjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Pra, të jetë e qartë, përveçse ka qenë një problematikë ku Parlamenti ka rënë dakord që t'i japë një zgjidhje kësaj çështjeje, ndoshta është rasti më i mirë që ta zgjidhim këtu, jo te ky nen, po flas në këtë kapitull, por nëse nuk thuhet diçka te ky nen, patjetër ne duhet ta zgjidhim më qartë diku tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

Ka vërejtje konkrete për nenin 124? Nuk ka.

Kalojmë te neni 15 i projektit, që është ndryshimi i nenit 125.

Po, zoti Rainer.

**Rainer Deville** – Lidhur me nenin 124, pika 2 kemi pasur disa komente nga ekspertët. Kushtetuta e vjetër është shprehur se Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës. Me sa kam kuptuar, në doktrinën ligjore kjo fjali do të thotë diçka tjetër. Ky formulim është gabim. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet dhe ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe

ligjeve të tjera përkatës. Formulimi duhet të jetë: “Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm aktet ligjore në kundërshtim me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare”. Kjo është ajo që ky nen kërkon të thotë sipas doktrinës shqiptare. Ky nuk përben një ndryshim të tekstit kushtetues, kështu që në qoftë se dëshironi të qartësoni se cili është kuptimi i këtij neni në doktrinën tuaj, ai duhet ndryshuar duke qenë se formulimi është tërësisht gabim. Ajo që nënkuptohet është se Gjykata Kushtetuese vlerëson aktet ligjore të cilat janë në kundërshtim vetëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe nuk është një instancë e re. Prandaj pyetja që shtrohet nga ekspertët është nëse dëshironi ta përdorni këtë mundësi për ta qartësuar apo dëshironi të vazhdoni me formulimin e vjetër me mënyrën se si e interpreton doktrina ligjore.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull. Mbajeni në vëmendje, por nuk më duket formulim i keq ky që është. Gjithsesi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk më duket i keq.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Fjala ishte për nenin 14.

Gjithsesi, të mbetet një çështje. Të bëjnë një formulim, ta shohim formulimin si do të jetë dhe pastaj të flasim mbi të, si dhe nëse do të pranohet që ta ndryshojmë ose jo. Në rregull?

Bëni një formulim të konsultuar me ekspertët e tjerë të fushës dhe të vendosim.

Neni 15, çështje që ka për nenin 15.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, neni 15 ka një seri çështjesh që kërkojnë një diskutim të kujdesshëm, të thelluar, që është një diskutim jo thjesht për të...

*(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)*

Duhet të jetë një diskutim i cili duhet të ketë një qasje jo thjesht teknike, por edhe një qasje, të themi për atë që jemi ne në komision politik, për të gjetur zgjidhje çështjet politike të ngritura në mënyrë konsistente nga opozita, por që besoj se edhe ju mendoni se duhen zgjidhur dhe, gjithashtu, e thonë qartë edhe ekspertët ndërkombëtarë, edhe Komisioni i Venecias: janë çështje me karakter politik dhe kërkojnë zgjidhje prej nesh. Ndaj, çështja e parë që vjen në këtë diskutim është shumica me të cilën do të përzgjidhen anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Flasim për ata anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi, për shkak se, po themi, për gjashtë anëtarët e tjerë

(tre dhe tre) është përcaktuar një formulë që besoj se është e validuara tashmë. Kështu që do të na duhet t'i japim një zgjidhje kësaj. Nëse ne nuk do të arrijmë ta zgjidhim dot sot çështjen e propozimit për votim me tre të pestat, kjo mund të jetë një çështje, e cila, e zgjidhur njëherë e mirë, do të na reflektohet edhe në këtë nen. Nëse nuk e arrijmë dot këtë zgjidhje sot, ta mbajmë në rezervën për t'i gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme, që do t'i aplikohet votimit me shumicë të cilësuar si në rastin kur kemi një kandidaturë ose një post (një vakancë që plotësohet), ashtu edhe në rastin kur kemi më shumë sesa një.

Komisioni i Venecias ka bërë propozime. Në diskutimin që ne kemi bërë edhe me partnerët ndërkombëtarë, kemi përzgjedhur dhe e kemi bërë të qartë se ne jemi për një pozicion të caktuar, që është formula me vende të rezervuara, por do të diskutojmë të gjithë që të gjejmë një zgjidhje përfundimtare.

Një çështje tjetër që kërkon...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres!

Unë bie dakord me ju në këtë pikë, që mbetet për ta trajtuar, pra këtë çështje do ta konsiderojmë në rezervë, në sensin që ky nuk është një nen i miratuar dhe nuk ka logjikë të quhet nen i miratuar nëse ne nuk zgjidhim çështjen e kuorunit, mënyrën sesi do të emërohen. Por besoj që ky do të jetë një problem që do ta ndeshim në shumë pika, do ta trajtojmë hap pas hapi dhe do të ulemi bashkërisht për ta zgjidhur për sa kohë është një ushtrim që do ta bëjmë ne si grup politik.

**Oerd Bylykbashi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Ekspertët mund të na ndihmojnë, por, në fund të fundit, na takon neve të gjejmë konsensusin dhe zgjidhjen më të mirë të pranueshme.

Unë mendoj se duke rënë dakord me këtë gjë, dua të them që kam përshtypjen se duke e parë nen pas neni, dhe, natyrisht, ne të dyja palët e dimë shumë mirë që nuk do të thotë asgjë ta shohësh ligjin nen pas neni, në qoftë se nuk e voton në tërësi e të tjera, duke krijuar pastaj zgjidhje teknike ne do të kuptojmë sesi do të vishet formatimi i tyre, pra si do ta trajtojmë këtë bashkë, në kuptimin që nga struktura, nga arkitektura e sistemit e të tjerë, do të shikojmë edhe se cili është raporti ndërmjet pushteteve, që mund të jetë zgjidhja më e pranueshme që ne bashkërisht, kjo është e sigurt, ne bashkërisht do të biem dakord për formulën e përzgjedhjes së tyre. Kështu që unë këtu ju mbështes dhe besoj që në ditët në vijim kjo do të jetë një çështje që

do të na shoqërojë hap pas hapi, por deri në fund ne do të jemi të detyruar, nuk kemi rrugë tjetër, të gjejmë bashkërisht një zgjidhje.

Kështu që mund të vazhdojmë normalisht me pikat e tjera.

Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Atëherë, po jap përcaktimet se cilat janë çështjet kryesore dhe pastaj ecim dhe shohim nëse ka çështje që mund të jenë të zgjidhshme te ky nen. Por, sigurisht, ky nen, duke qenë edhe neni kryesor i kësaj pakete, përmbledh çështjet kryesore.

Gjithashtu, një çështje që mbetet për zgjidhje që është qoftë e aspektit, po themi të karakterit politik, është ajo që ne kemi shtruar, çështja e kapjes politike, që nuk duhet të jetë problem as sot, as në të ardhmen dhe që është po aq sistemike si çështje, është ajo e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kompetencat, funksionet që ka ky këshill, përbërja e tij dhe roli që ka në fund fare, po themi, produkti që prodhon, pra jo vetëm një përzgjedhje sipas kushteve dhe kritereve, por edhe renditja. Sigurisht që çështja e shumicës së cilësuar na jep edhe nevojën për t'i gjetur një zgjidhje që e çon deri në fund procesin, pra na garanton zgjedhjen e kandidatëve, por ne e kemi konsideruar si një çështje që kërkon vendimmarrje politike dhe marrëveshje politike edhe në lidhje se cilat janë ato institucione që do të jenë pjesë e sistemit dhe ç'rol do të ketë secili sistem.

Kështu që unë besoj, duke qenë se ky është neni i parë që ekspozohet karshi çështjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, se jemi në kushte të ngjashme. Nuk është vetëm ky nen, por do të kemi edhe nene të tjera ku do ta zgjidhim këtë çështje. Me siguri kjo zgjidhje do të na reflektojë versionin përfundimtar të këtij neni.

Përtej kësaj, sikur kjo të jetë e zgjidhur, do të na duhet të përcaktojmë qartë edhe gjuhën që do të përdorim në nen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Majko, me pak durim! Besoj se e keni parasysh që radhës që shkoi unë thashë: durimi do të na bëjë të ecim më shpejt sesa nxitimi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, meqenëse e kërkon në mënyrë më specifike, merr përsipër në këtë nen të mbrojë renditjen, pra jo vetëm përzgjedhjen, e kandidaturave për Gjykatën Kushtetuese, në mos e bëjnë edhe për Presidentin e Republikës. Ndërkohë që për

pjesën që vjen nga dy gjykatat e Larta, tre anëtarët e tjerë do ta bëjnë vetë këta, pra nuk do të ketë një renditje.

Nëse do ta bëjë KED-ja një renditje të tillë, a duhet ta bëjë edhe për rastin e gjykatave, apo jo? Kjo është njëra çështje, por themelore është a do të ketë një rol definitiv KED-ja në këtë çështje?

A do të jetë renditja mekanizmi që zhbllokon vendimmarrjen, apo do të kemi një zgjidhje tjetër? A do të jetë renditja që vjen nga një proces votimi, apo do të jetë një organ elitar që do ta bëjë këtë? Kjo është një çështje që kërkon një zgjidhje që është sa teknike, aq edhe politike.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka një përbërje të ndryshme nga ajo që ka qenë fillestare, por i pazgjidhur ai përfundimisht, kjo ndikon te kjo dispozitë.

Një çështje tjetër, zoti kryetar, që kemi këtu është fakti se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese e zgjedhin kryetarin e tyre nga radhët e tyre, se kjo është normale, por problemi është pika gjashtë. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga radhët e tyre me një formulim që, në fakt, është shumë ekstensiv për një tekst kushtetues dhe kështu siç është, ndoshta tentativa për ta mbajtur sa më të përmbledhur të mundshëm formulimin, çon në një konfuzion shumë të madh.

Kjo nuk është histori thjesht e të shikuarit më qartë. Në qoftë se ne do të kemi një sistem votimi ose përzgjedhjeje të kryetarit, i cili mund të kolapsojë në një moment të caktuar, sigurisht që kjo handikapon edhe funksionimin e gjykatës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për ilustrim, në qoftë se neni në votimin e parë sot nuk merr shumicën e rregulluar prej pesë votash, bëjmë një votim të dytë midis dy kandidatëve kryesorë, kështu thotë neni. Por në qoftë se kemi tri kandidatura dhe secila merr tri vota, te kjo nuk është e parashikuar.

A do të ketë mundësi Gjykata Kushtetuese të zgjedhë nëpërmjet një rregulli specifik, kur ka vetëm një kandidaturë dhe jo dy a më shumë? Si do të zgjidhet problemi i “a kanë të drejtë anëtarët që të abstenojnë, për rrjedhojë numri i votave të totalizuara nuk do të jetë nëntë”, apo çfarë ndodh me një votë të pavlefshme në një trupë prej vetëm nëntë gjyqtarësh të nivelit më të lartë të mundshëm, çka është një votë e qëllimshme e pavlefshme, apo jo? Kjo reflekton tek ambiguiteti total dhe këto janë çështje (unë besoj se kuptohemi te kjo pjesë), që mund të mos na funksionojnë, sepse është vështirë për t’u kuptuar sesi kur votojnë në balotazh

midis dy kandidaturave të dalin me numër të barabartë votash, kur janë nëntë vota për t'u ndarë. Njëri duhet të marrë pesë; është e pamundur. Pra, nuk shtrohet problemi në kushtet kur nuk ka abstenim dhe nuk ka votë të pavlefshme.

Po kështu, zgjidhja që i jepet aty që kur asnjë kandidat nuk merr shumicën e kërkuar prej pesë, asnjëri prej kandidatëve, thuhet që e merr kandidati me më shumë vota.

Çfarë ndodh kur kemi të lejuar abstenimin apo kemi vota të pavlefshme, të cilat e bëjnë ndarjen tre me dy, dhe të gjitha votat e tjera janë të pavlefshme? Këto janë të gjitha zgjidhje të cilat këtu nuk funksionojnë dhe ndoshta ka qenë e vështirë për ekspertët që në një tekst kaq të ngushtë t'i parashikojnë të gjitha këto. Ky është një problem i cili nëse nuk zgjidhet, mund të na çojë në një bllokim të zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili me ligj ka një numër detyrash të rëndësishme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë gjykoj se një nga çështjet që duhet të diskutojmë këtu për këtë nen është edhe parashikimi që anëtari i Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale. Neve na duhet që këtë dispozitë, këtë formulim me një fjali të vetme ta harmonizojmë, sepse kjo duket sikur bie ndesh me nenin 6/1 të miratuar në dhjetor. Në atë dispozitë, në mënyrë të qëllimshme, është parashikuar efekti i atij neni në të gjitha organet kushtetuese. Kështu që është e nevojshme që kjo të harmonizohet.

Një tjetër çështje, që ne duhet të zgjidhim, zoti kryetar, është nëse perioda ndaluese për personat, të cilët kanë pasur një funksion politik duhet të jetë dhjetë vjet ose diçka më e shkurtër. Në dukje të parë duket sikur kjo barazohet me ndalimin dhjetëvjeçar, që kanë personat të cilët janë dënuar më shumë se dy vjet me burg dhe për shkak të ligjit të dekriminalizimit nuk mund të ushtrojnë funksione politike ose publike. Ky është një diskutim, po themi, për të parë oportunitetin duke ruajtur nga politizimi një organ të këtillë dhe të shohim nëse... Pra, nuk është çështje kryesore, por mbetet për një diskutim të ftohtë për sa na takon.

Një çështje tjetër është qëndrimi i anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në detyrë deri në momentin që zëvendësohet. Sigurisht, edhe këtu duhet të gjejmë një zgjidhje në mënyrë që procedurat, rregullat që do të ndiqen dhe afatet të jenë të tilla që ky përjashtim të mos bëhet rregull në këtë gjykatë, por të arrijmë që ta disiplinojmë zëvendësimin e anëtarëve brenda afateve, afatit nëntëvjeçar që është mandati, dhe në raste të rralla mund të kapërcehet për një kohë të shkurtër.

Këto ishin një seri çështjesh që unë besoj se duke filluar nga ato që janë me karakter politik dhe kërkojnë një zgjidhje në mos sot, më vonë mund të diskutohen dhe të gjenden kompromise midis sot dhe ditëve që vijnë.

Ky është neni kryesor i kësaj pakete, kështu që besoj se ia vlen të ndalemi pak.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Me sa kuptoj unë, çështja që ka dhe do të vazhdojë të ketë nevojë është ajo e shumicave që ne sqaruam dhe biem dakord.

Për sa i përket çështjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, te neni përkatës i Këshillit të Emërimeve do të diskutojmë lidhur me formatimin e këtij këshilli, funksionet, detyrat, raportin që ai ka, rolin që ka në këtë proces dhe mënyra sesi do të vlerësohet Këshilli i Emërimeve, ndërsa çështjet e tjera janë të natyrës së mirëfilltë teknike. Kështu që unë do t'u kërkoja kolegëve propozime, sugjerime konkrete që t'u japim mundësi ekspertëve të punojnë konkretisht nëse ka diçka.

Po, zoti Majko.

**Pandeli Majko** – Tani unë dua të flas për procedurën fillimisht, zoti kryetar. Ne po diskutojmë nene dhe në qoftë se do të diskutojmë nene, të paktën në eksperiencën time modeste kur dikush flet, nuk ngrihen çështje në parim, të cilat e hapin diskutimin edhe një herë nga fillimi.

Me sa di unë, çështjen e statusit të Këshillit të Emërimeve ne e kemi të mbyllur. Ndaj, duke pasur parasysh edhe rezymenë që bëri ish-nënkryetari i komisionit, i cili tani është larguar për arsye shëndetësore, janë evidentuar se cilat janë pikat e hapura.

Në dijeninë time, të paktën nga leximi i procesverbalit, statusi i Këshillit të Emërimeve nuk ka qenë çështje e hapur, si çështje për t'u diskutuar politikisht. Kështu që ne nuk kemi pse i hapim këto çështje sa herë dikush mendon që kjo është një çështje politike. Infrastruktura e reformës së drejtësisë është e mbyllur në këtë pikëpamje. Kemi lënë për të diskutuar politikisht mënyrën e votimit.

Së dyti, nëse diskutojmë për nene, secili që ka një opion të ndryshëm, do të duhet të flasë me terma konkretë: çfarë mendon se si duhet të jetë forma e paragrafit ose e nenet që diskuton.



Në këtë këndvështrim unë do të thosha që ekspertët kanë punuar mjaft mirë, sidomos për paraqitjen e vërejtjeve të Komisionit të Venecias, por mendoj se disa nga vërejtjet e Komisionit të Venecias mund të gjejnë pasqyrim jo të gjitha në draftin e ndryshimeve kushtetuese, por ato mund të implementohen krejt normalisht në ligjin përkatës. Pra, jo çdo detaj, sipas opinionit tim, duhet të përfshihet në nenet e Kushtetutës.

Unë propozoj që paragrafi i parë të jetë i një natyre të tillë: “Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë emërohen nga Kuvendi dhe tre anëtarë emërohen nga mbledhja e përbashkët e Gjykatës së Lartë dhe asaj Administrative. Anëtarët që emërohen nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi përzgjidhen nga kandidatët e renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në tri vendet e para të listës”.

Paragrafi që flet për “Procedurat e përzgjedhjes, të emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese garantojnë standardet e kandidimit të hapur, konkurrimit të ndershëm, transparencës dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të kualifikuar...” të hiqet si paragraf nga ky nen kushtetues, pasi ai normalisht mund të vendoset në ligj dhe pastaj është shumë e qartë.

Paragrafi i dytë propozoj që të shkruhet: “Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Kur në votimin e parë Kuvendi nuk siguron shumicën e kërkuar prej 3/5-ve, brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së listës së kandidatëve nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari konsiderohet i emëruar.

Për paragrafin e tretë nuk kam asnjë vërejtje.

Për paragrafin e katërt, po ashtu nuk kam vërejtje. Mendoj të shtohet një paragraf i pestë: “Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me 1/3-n e saj, sipas procedurës të përcaktuar me ligj”.

Në paragrafin e gjashtë mendoj të shkruhet: “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë me shumicën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë”. Pjesa: “Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk merr në votimin e parë shumicën e kërkuar, zhvillohet votimi i dytë për dy kandidatët e tjerë, të cilët kanë marrë më shumë vota. Në rast se pas votimit të dytë asnjë prej kandidatëve nuk merr shumicën e kërkuar të votave atëherë zgjidhet kandidati me më shumë vota. Në rast të barazisë së votave kryetari zgjidhet me short” mendoj që mund të hiqet dhe mund të implementohet në ligjin përkatës dhe neni të vazhdojë me frazën: “ligji parashikon kriteret dhe procedurat e

hollësisht për përzgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”. Nuk mendoj që ne mund të vazhdojmë e të diskutojmë me hollësi se si do të zgjidhet Kryetari i Gjykatës Kushtetuese në një kohë që kjo mund të zgjidhet krejtësisht për ligjin në fjalë.

Në pikën shtatë, shtoj vetëm disa pika të vogla është “gjqytari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafet “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”. Ky është propozimi.

**Fatmir Xhafaj** -Ajo që kuptoj unë, për ta përmbledhur, ajo çfarë tha zoti Majko dhe që në një farë mase përputhet edhe me atë që trajtoi zoti Bylykbashi, është që ka një kujdes të tepruar të ekspertëve për të vendosur hollësisht në Kushtetutë. Deri në këtë moment kjo ka qenë një gjë shumë e mirë. Pse ka qenë gjë e mirë? Sepse ka pasur nevojë që palët të binden se çfarë janë duke bërë. Ka pasur nevojë që vetë Komisioni i Venecias të kuptojë nëse kishte gjë tjetër pas kësaj.

Cili ka qenë qëllimi i legjislatorit? Deri ku shkon? Ky parim kushtetues rrezikon të dëmtohet nga detajet. Tani është e nevojshme që Komisioni i Venecias, arbitri që e bëri këtë gjykim dha mbështetje për këto lloj zgjidhjesh. Ne jemi të qartë se ku duhet të shkojmë. Është shumë pozitive që disa nga këta elementët që kanë natyrën e ligjit të shkojnë te ligji “Për Gjykatën Kushtetuese” që duhet të vijë po këtu.

Në dijeninë time ligji ka përfunduar si draft dhe është në procesin e konsultimit dhe do të vijë pastaj së bashku me paketën tjetër për t’u diskutuar dhe miratuar, si për të kaluar në seancë plenare. Kështu që disa detaje do të jenë të nevojshme. Kjo, hidhet shorti, nuk hidhet, këto mund të jenë në ligj të gjitha, nuk ka në Kushtetutë. Nuk është në natyrën e një norme kushtetuese, ose procedura e përzgjedhjes. Dakord, qëllimi ka qenë dhe unë e mirëkuptoj. Ne i qëndrojmë besnik asaj çfarë ka thënë Venecia, por këtë e reflektojmë tek ligji, për sa kohë që jemi të qartë këtu se ajo që duam të bëjmë është kjo. Disa gjëra, detaje e kanë vendin në ligj dhe ne duhet të biem dakord që do ta kenë vendin në ligj. Kushtetuta është Kushtetutë, ligji është ligj, kjo nga pikëpamja teknike. Kështu që mua më duken propozime me interes, një nen i plotësuar me gjithë këto të tjerat do të duhet të rishikohet.

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, në vijim të këtyre diskutimeve në fund fare sigurisht që duam të bëjmë një nen sa më elegant, në aspektin e tekstit kushtetues. Por, kjo, nga ana tjetër, ekspozon ndonjëherë një nevojë që është fiziologjike e këtij procesi, për të pasur arsytet pse ne i

kemi shkruar këtu që të kemi të gjithë të dimë se çfarë po flasim dhe të kemi besim se çfarë do të biem dakord, po aq e bën të nevojshme që ky nen dakordësohet kur dihet që nenet e ligjit nuk e alterojnë atë që bie dakord. Dakord kjo këtu, por nuk mund të rrijë në këtë nen, do të shkojë në ligj, sepse në fund fare ne jemi të veshur me përgjegjësinë për të hartuar një paketë të plotë të reformës në drejtësi. Do të ketë shumë punë. Në momentin që e shohim të tërën, kjo i hap dritën jeshile plotësisht kësaj.

Pra, për të shprehur dhe unë atë merakun tim në fund fare që përfaqëson një shqetësim të opozitës, në ditën që shohim 360 gradë këtë zgjidhje besoj se ne do të jemi plotësisht të qetë që kemi bërë një nen i cili mund t'i qëndrojë jo vetëm testit të kohës, por dhe testit politik në votimin në parlament.

**Fatmir Xhafaj** – Unë i kuptoj ndjeshmëritë që mund të ketë, besimi, mosbesimi, që na shoqëron në gjithë këtë proces dhe për arsye të ndryshme është i justifikuar. Ashtu siç mirëkuptoj të gjithë skepticismin që rrethon këtë reformë lidhur me pritshmëritë e saj, siç është mungesa e besimit te qytetarët që ne do të jemi të aftë ta bëjmë këtë gjë dhe që do të prodhojmë një gjë që u intereson atyre. Është një gjë e arsyeshme dhe nuk duhen keqkuptuar të gjithë as ata jashtë, por edhe për më tepër ne këtu në tavolinë. E kam thënë dhe po e përsëris: projekti do të shoqërohet me 7 projektligjet bazë këtu në këtë tavolinë. Në momentin që ne e mbyllim në tërësi projektin do të fillojë diskutimi i projektligjeve dhe në parlament do të shkojë paketë. Pra, projektligji kushtetues me 7 ligjet kuadër. Ky është një angazhim që ne e kemi dhënë, e kemi diskutuar.

Ne si mazhorancë kemi qenë të qartë. Është dashur nga ju që të merret kjo garanci, por po jua ripërsëris përsëri. Do të shkojë në këtë mënyrë, sepse dhe ne vetë jemi të ndërgjegjshëm dhe e kemi të nevojshme që të votohet një paketë e plotë në parlament. Gjërat që nuk na bindin, do t'i shohim se si janë reflektuar te ligji dhe kemi të gjithë kohën pastaj t'i axhustojmë.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

Edhe unë kam dy pyetje, paqartësi dhe sugjerime për këtë nen, duke mos hequr asnjë presje nga diskutimi i kolegut. Pra, jam dakord që një pjesë të shkojë te ligji. E kam për shtesën për paragrafin 2 dhe pyetjen e kam për ekspertët. Në paragrafin 2 thuhet se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të zgjidhen nga Kuvendi. Që në fillim thuhet se kur votimin e parë Kuvendi nuk siguron shumicën e kërkuar prej 3/5-ve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës kandidati i renditur më lart konsiderohet i emëruar. Afati 30-ditor që parashikohet me listë është afati i cili duhet përllogaritur që në momentin kur në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar nga Këshilli i

Emërimeve në Drejtësi lista, apo afati 30-ditor është afati që fillon që nga momenti kur mbaroi votimi i parë nuk është siguruar shumica e kërkuar prej 3/5-ve.

**Fatmir Xhafaj** – Kjo është një gjë që do ta sqarojë ligji. Këtu jepet afati. Nuk mundet Kushtetuta të rrijë tani të caktojë kur hyn... Cili është formulimi?

**Vasilika Hysi** – Formulimi nuk e bën të qartë nëse ky afat 30-ditor është detyrim për Kuvendin që brenda 30 ditëve të sigurojë votimin e parë apo është një afat i cili lind që nga momenti që Kuvendi nuk e ka siguruar shumicën e kërkuar, brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës...

**Fatmir Xhafaj** – Brenda 30 ditëve Kuvendi është i detyruar të votojë.

**Vasilika Hysi** – Në rast se ka kuptimin që brenda 30 ditëve duhet bërë e gjithë procedura nga ana e Kuvendit ky afat, për mendimin tim, është i shkurtër. Pse? Këtë e kam bazë me përgjigjen edhe një argument. Rregullorja e Kuvendit ka një procedurë se si vjen kandidatura, si miratohet kalendari dhe programi i Kuvendit në Konferencën e Kryetarëve. Më pas do të kalojë në Komisionin e Ligjeve, do të ketë një seancë dëgjimore që të bëhet përzgjedhja midis kandidatëve të rreshtuar. Në këtë kuadër i gjithë ky proces brenda 30 ditëve, duke pasur parasysh dhe Rregulloren e Kuvendit dhe gjithë këto lloj procedurash, janë të ngushta. Ose nëse do të lihet afati 30 ditë atëherë ne duhet të sugjerojmë...

**Fatmir Xhafaj** -Afatin 30 ditë do ta lidhim me miratimin e Komisionit të Ligjeve.

**Vasilika Hysi** – Por në rast se ne do të lëmë këtë afat, do të sugjeroja që ne duhet të propozojmë si komision Kuvendit edhe rishikimin e Rregullores së Kuvendit në qoftë se duam këtë lloj shpejtësie.

**Fatmir Xhafaj** -Mbajeni shënim këtë që t'ia sugjeroni grupit të Kushtetueses që ta ketë parasysh te ligji “Për Gjykatën Kushtetuese”.

**Vasilika Hysi** - Çështja e dytë është për ekspertët. Ndoshta edhe ju që i keni ndjekur nga afër punimet e grupit të ekspertëve të reformës kushtetuese. Ju thoni në paragrafin e pestë që ripërtëritja bëhet çdo 3 vjet. Por unë në të gjithë projektin e paraqitur nuk shoh se si do të bëhet përtëritja sapo të miratohet ligji. Pra, çfarë do të bëhet me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që janë aktualisht në detyrë? Pra, a mendoni se duhet të kemi një rregullim të dispozitave kalimtare për të filluar procesin e përtëritjes çdo 3 vjet dhe për t'u futur më pas në normalitet?

Po, zoti Rainer.

**Rainer Deville** – Së pari, lidhur me strukturën se çfarë mund të vendoset në Kushtetutë dhe në ligj. Ne ramë dakord që teksti kushtetues është mjaft i detajuar dhe duhet kontrolluar se çfarë mund të heqim për zbatimin e ligjit. Sipas Kushtetutës në fuqi, përzgjedhja e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese bëhet nga Presidenti i Republikës dhe kjo është arsyeja përse është rregulluar në Kushtetutë pasi këtë funksion e ka një organ kushtetues. Kjo do të ndryshojë në të ardhmen. Pra, ju mund të merrni paragrafet 3, 4, 5, 6 në ligjin zbatues nëse vazhdoni me fjalinë e fundit të numrit 6, kriteret e detajuara dhe procedura në Gjykatën Kushtetuese, dhe të shtoni “gjyqtarët dhe kryetari do të parashikohen me ligj”. Nëse e keni këtë fjali në Kushtetutë, ne mund të kopjojmë paragrafet 3, 4, 5, 6 në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe mendoj se mund të bini dakort politikisht për përmbajtjen. Unë besoj paragrafet 1 dhe 2 parashikojnë përbërjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe besoj se këto dy paragrafe duhet të mbeten në Kushtetutë pasi kanë të bëjnë me thelbin e Gjykatës Kushtetuese.

Nëse shikoni afatin 30 ditor në paragrafin 2, aty shprehet qartës që me paraqitjen e listës se kandidatëve në Kuvend, pra kjo gjë është thënë qartësisht. Nëse tani thoni që ky afat prej 30 ditësh është shumë i shkurtër për procedurat që ne ndjekim në Parlament pasi mund të kërkojmë zhvillimin e një seancë dëgjimore dhe prezantimin e kandidatëve, askush nuk po insiston në afatin 30-ditor. E rëndësishme është që ka një mekanizëm zhblllokues, që nuk duhet të zgjasë përgjithmonë. Nëse ju ndryshoni procedurën për ta bërë më të shpejtë ose thoni që në vend të 30 ditëve na duhen 6 javë, mendoj që ky nuk është thelbi i çështjes. Thelbi është që nëse Kuvendi nuk merr një vendim, atëherë zbatohet mekanizmi zhblllokues. Nëse dëshironi të zëvendësoni periudhën 30-ditore me 6 javë, kjo është e mundur.

Në pikën 4 bëhet fjalë për kandidatët që nuk duhet të ishin dënuar. Këtu shohim të njëjtin problem që kemi parë edhe herën e fundit me nenin 6/1. Pyetja është nëse do të jetë një kufizim i përjetshëm apo jo. Këshilli i Europës rekomandon që nuk duhet të zgjasë përgjithmonë por vetëm për një periudhë. Formulimi më i zgjuar do të ishte që kandidati nuk duhet të ketë rekorde kriminale, dhe më pas përcaktoni se për sa kohë dhe kur fshihet. Kjo do të ishte një qasje proporcionale. Ky është edhe debati që patëm herën e fundit dhe duhet të jetë në përputhje me ndryshimet e nenit 6/1.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ta mbyllim këtë diskutim, sepse ishte një detaj teknik. Unë bie shumë dakord me zotin Rainer që duhet të ketë një afat që ta disiplinojë procesin. Se është 30 ditë, se është 45 ditë do ta

shikoni në tërësi. Do t'ju lutem që të gjithë të jemi më koncizë. Edhe ne që kërkojmë ndërhyrje për nenet kolegeve po ju them që të jeni shumë më konciz, se kështu ne nuk do të mbarojmë kurrë.

**Petrit Vasili** – Sugjerimi është shumë i shkurtër për sa i takon nenit 2. Për se do ta përdorim konceptin e votimit të parë? Ose do të përcaktojmë që kemi votime të njëpasnjëshme, ose të themi një votim, se krijon konfuzion. Është një votim i parë i cili nuk shoqërohet me të tjerat. Mbetet një gjë pezull që duhet saktësuar.

**Oerd Bylykbashi** - Shqetësimi që ma precizoi zoti Vasili është pikërisht ky. Është ndeshur dhe një herë më parë në Kushtetutë një situatë e tillë. Ne duhet ta saktësojmë patjetër. Duhet patjetër një disiplinim dhe një mekanizëm zhbllokues, siç thonë ekspertët ndërkombëtarë. Ne duhet të shohim edhe mundësinë që brenda këtij afati parlamentit t'i japin të paktën dhe një herë të dytë të tentojë. Dhe ndoshta mekanizmi i renditjes do të na funksionojë midis një grupi kandidaturash të testuara tashmë dy herë nga Kuvendi. Dhe merret dhe ai që ka po themi renditjen më të lartë në mekanizmin që do të gjejmë ne për ta zhbllokuar këtë.

Por e para, duhet qartësimi që thotë zoti Vasili.

E dyta, na duhet t'i japim Kuvendit dhe një shans të dytë. Shansi i dytë, gjithashtu, dhe krijimi i një grupi kandidatësh i cili e prish parashikueshmërinë më pas, por na jep zgjidhjen finale të kandidatura më e mirë e mundshme, do të ishte me vend dhe e shëndetshme për të eliminuar disa nga ato probleme që ne shtrojmë si momente të kapjes ... Kështu që një këndvështrim i kujdesshëm sa teknik edhe politik do të na japë zgjidhje.

**Fatmir Xhafaj** - Ka gjë tjetër për këtë nen? Nuk ka. Kështu që do të reflektohen detajet për ta parë të plotë. Dhe në momentin që mbyllim edhe çështjen e shumicave, do të vendosim përfundimisht për këtë nen.

Faleminderit!

Vazhdojmë me nenin 16 që është ndryshimi i nenit 126.

Po.

**Pandeli Majko** – Unë kam vetëm një riformulim të vogël. Po e lexoj të plotë: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi të paligjshëm si pasojë e një vepre penale, interesi personal ose keqbesim.

**Fatmir Xhafaj** – Sjellje kriminale me vepër penale.

**Pandeli Majko** – Dhe keqbesim nga keqdashja...

Keqbesim është më e kuptueshme tek ne.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Oerd Bylykbashi** – Këtu na lind një çështje në definicion.

Së pari, kemi 3 nivele të ndryshme. Është sjellja kriminale, që është vepër penale. Interesi personal, që tregon konfliktin e interesit dhe kemi edhe keqdashjen. E para është se si do të definohet keqdashja. Pra, a është diçka e abuzueshme? Kush do të jetë ai që do ta përcaktojë në fund fare?

Dhe e dyta, cilat janë pasojat e kësaj? Do të jenë këto të lidhura edhe me procedimin disiplinor që ndiqet. Sepse në rastin e një sjelljeje kriminale sigurisht që kemi edhe një hetim. Pra, është diçka që duhet mbajtur parasysh në mënyrë që të jetë i paabuzueshëm, sidomos kjo fjala e fundit. Qoftë keqdashje, qoftë keqbesim, të dyja kanë nevojë për të parë se sa strikt do të jetë niveli që do të masim për të çuar më pas në përgjegjësinë e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Kjo është shumë sintetike. Ne këtu kemi një koncept të dhënies qëllimisht. Dhënia qëllimisht për mua është një koncept fare pa kuptim, dhënies së njëanshme të një vendimi po, sepse gjithmonë në një gjykim ka dy palë. Është njëra anë dhe ana tjetër. Një vendim i njëanshëm është një vendim subjektiv, e influencuar nga rrethana të tjera. Kurse qëllimisht, joqëllimisht janë të pamatshme. Ne dimë dhe në shumë koncepte të tjera që përdoren në legjislacion është mendimi i anshëm. Mendimi i anshëm është një mendim subjektiv, i padrejtë. Vendimi i paanshëm është një vendim i drejtë. Kështu unë do të sugjeroja që në vend të fjalës “qëllimisht” të vinim fjalën “i njëanëshëm”. Kjo do të ishte konkrete dhe më e qartë për çfarë flasim.

**Fatmir Xhafaj** - Kjo është çështje paligjshmërie. Këtu kërkohet qëllimi në këtë rast. Është e domosdoshme ta theksojmë qëllimin për efekt të përgjegjësisë që do të ketë nesër, jo pasoja.

**Fatmir Mediu** – Ne flasim për paligjshmërinë dhe njëanshmërinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Problemi është se kush do ta çmojë paanshmërinë dhe paligjshmërinë e Gjykatës Kushtetuese, të organeve që u kemi dhënë autoritetin juridik? Është autoriteti juridik

më i lartë që gjykon Kushtetutën e vendit dhe kushtetutshmërinë e procesit. Te elementi i vetërregullimit është çështja.

**Fatmir Xhafaj** - Pra, gëzon imunitet, përjashto 2-3 raste. Dhe për këtë vlerësimin e tyre, kur është përgjegjësia disiplinore, do ta bëjë vetë gjykata. E keni të përcaktuar më poshtë, ndërsa për përgjegjësitë penale organet e drejtësisë penale.

Po.

**Arben Ristani** – Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e nenit të Kodit Penal, i cili merrte në përgjegjësi penale gjyqtarët, për rastin e dhënies së vendimeve haptazi në kundërshtim me ligjin. Ka qenë një dispozitë në Kodin Penal për këtë dhe ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese që këtë nen e ka konsideruar antikushtetues dhe sot nuk është më në Kodin Penal.

**Fatmir Xhafaj** – Ne po rregullojmë Kushtetutën.

**Arben Ristani** – Doktrina kushtetuese sot sipas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk e imponon Gjykata Kushtetuese nëse do të ketë rregullim kushtetues, do të bëjmë nenin...

**Fatmir Xhafaj** – Le ta ketë bërë interpretimin. Ai ka interpretuar një normë të caktuar.

**Arben Ristani** – Duhet ta kemi parasysh një gjë të tillë.

**Fatmir Xhafaj** - Dakord, t'i japim mundësinë ta shikojnë.

**Oerd Bylykbashi** - Duke mbështetur një moment kolegun Ristani, kjo ka të bëjë me parimin e pavarësisë së gjyqtarit që nuk është vetëm varësi e tij nga Kushtetuta dhe ligji, por është edhe bindja e brendshme. Ai e çmon në mënyrë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po dhe vendimi, këtu pastaj më vjen me shumë arsye ajo që tha zoti Vasili që të gjithë gjyqtarët marrin vendime në mënyrë të qëllimshme. Qëllimi është dhënia e drejtësisë dhe arsyeja të çon në një qëllim që është i ligjshëm. Këtu fjala që bën diferencën është marrja e një vendimi të paligjshëm, si pasojë e asaj që vjen. Pra, paligjshmëria lidhet me këto elementet që vijnë pas, që kanë nevojë për diskutim, por qëllimi në vetvete nuk na thotë shumë, sepse këtu kemi të bëjmë me diçka që është me dashje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për ta mbyllur, do të na vijë problemi që organi disiplinor që do të disiplinojë Gjykatën Kushtetues duke pasur diskrecion që shkon te ligji dhe jo te Kushtetuta, do t'i ulte kokën



Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që është organi, të cilit i kemi dhënë mundësi të interpretojë Kushtetutën në mënyrë përfundimtare. Këtu duhet të jemi ekstremisht të kujdesshëm në raportin që krijohet në *check and balance* që krijohet brenda sistemit.

**Arben Ristani** – Çfarë duam të krijojmë nëpërmjet kësaj dispozite? Çfarë imuniteti i japim gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese me këtë dispozitë? Duket si dispozitë pa kuptim. “Gëzon imunitet në vendimet e shprehura”, në rast se ai kryhen veprë penale, në rast se ai përfshihet në ryshfet, në rast se ne e rifusim në Kodin Penal dispozitën e dhënies së vendimit të paligjshëm...

**Fatmir Xhafaj** – Për një gjë që ai e ka shprehur aty, për një gjë që është në vendim, ai nuk mban përgjegjësi, kjo është logjika.

**Arben Ristani** – Mendimet që shpreh gjyqtari...

**Fatmir Xhafaj** - Po, e ka edhe në Kushtetutën aktuale të njëjtën normë.

**Arben Ristani** – “Përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi të paligjshëm”, ka një problem: dhënien e një vendimi qëllimisht të paligjshëm, sot nuk e kemi të kriminalizuar, nuk e kemi dispozitë në Kodin Penal, a do ta shtojmë këtë dispozitë në Kodin Penal?

**Fatmir Xhafaj** – Ndoshta do të bëjmë rregullim kushtetues, do të reflektohet, por nuk udhëhiqemi nga Kodi Penal për të ardhur te Kushtetuta, por nga Kushtetuta do të shkojmë te Kodi.

**Arben Ristani** - Ne duhet të shkojmë te Kodi Penal dhe të ndërtojmë një dispozitë. Sot kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese që këtë dispozitë e ka konsideruar antikushtetuese. Pra, kemi një praktikë kushtetuese të cilën do ta mendojmë se do ta hedhim poshtë apo do ta marrim parasysh? Kjo do të kriminalizojë të gjithë, do të rivëmë në Kodin Penal një dispozitë, të cilën Gjykata Kushtetuese e ka hequr sot.

**Fatmir Xhafaj** - Gjykata Kushtetuese ka interpretuar normën kushtetuese që është aktualisht dhe ka hequr normën në Kodin Penal.

**Arben Ristani** - Ne do ta rivëmë.

**Fatmir Xhafaj** - Po, patjetër, ne do ta pranojmë.

**Arben Ristani** - Nëse do ta rivëmë, ku e çojmë ne praktikën kushtetuese të këtij vendi?

**Fatmir Xhafaj** - Ajo interpreton për sa kohë që ke pasur një rregullim kushtetues të caktuar. Tani do të kesh një rregullim kushtetues të ri dhe t'i do ta futësh këtë, do të mbajë përgjegjësi patjetër...

**Petrit Vasili** - Ndoshta nuk na zgjidh ndonjë problem të madh formulimi, por thjesht për të thënë që gëzon imunitet dhe t'i vëmë pikë kësaj gjëje, pastaj të vazhdojmë tjetrën. Të stabilizojmë brenda nenit dy koncepte që gëzon imunitet dhe mbaron këtu dhe më tutje vazhdojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dua të them se ndan dy koncepte, sepse duket sikur në vazhdim të njëri-tjetrit, njëri bën relativ tjetrin. Kjo është historia.

**Vasilika Hysi** - Neni 126 aktual i Kushtetutës është shfuqizuar komplet. Pra, ajo që kupton zoti Vasili nuk është e saktë. Nuk ka më imunitet. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë imunitet nga ndjekja penale.

**Fatmir Xhafaj** - Kanë mbrojtje për vendimet...

Zonjë, kjo është e rëndësishme, sepse ka të bëjë me pavarësinë.

**Vasilika Hysi** – Kanë imunitet vetëm për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksionit të tyre.

**Fatmir Xhafaj**- Siç kemi ne imunitet për mendimet që shprehim në Parlament. A shprehim ne mendime në Parlament? Po!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për sa kohë që ai nuk e ka bërë këtë për të dhënë një vendim të padrejtë.

**Vasilika Hysi** – A të mbaroj, sepse kam marrë fjalën? Kam një pyetje: sjellja kriminale që nuk është terminologji shqiptare, por është e huaj, vepra penale, konflikti i interesit dhe keqbesimi, duhet të jenë vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë?

**Fatmir Xhafaj** - Zoti Rainer për ta përmbyllur këtë diskutim.

**Rainer Deville** – Ekziston një parim, sipas të cilit çdo gjyqtar mund të gjykojë bazuar në konkluzionet e gjykatës, dhe ajo që vendos gjyqtari është vendimi i tij/saj. Zgjidhja ndaj vendimit të gabuar është apelimi në shkallën tjetër. Ky është parimi. Ky parim që përmendim këtu, vlen edhe për gjyqtarët e tjerë. Megjithatë, ky parim nuk zbatohet nëse gjyqtari nuk po vendos për një çështje, por po vepron p.sh për shkak të një rryshfeti. Kështu që, në rast se gjyqtari merr një vendim të gabuar me vetëdije për shkak se ai ose ajo është paguar, atëherë

gjyqtari duhet të mbajë përgjegjësi penale për këtë vendim dhe ai ose ajo mund të ndiqen penalisht. Për këtë veprim me keqdashje, gjyqtarët duhet të mbajnë përgjegjësi dhe nuk duhet të kenë imunitet. Nëse në Kushtetutën dhe legjislacionin aktual është ndryshe, atëherë duhet ta ndryshoni legjislacionin pasi në këtë mënyrë luftoni korrupsionin dhe ky është qëllimi i reformës për të rivendosur besimin. Nëse doni të ndryshoni formulimin, mund të thoni që është një vepr penale me dashje e kryer nga gjyqtari gjatë procesit të vendimmarrjes. Ndoshta mund ta shkurtoni por ky është koncepti. Ne vëmë re që gjyqtarët gëzojnë shumë imunitet dhe kjo bëhet pengesë për ta ndryshuar sistemin dhe ky parim duhet të zbatohet për të gjithë gjyqtarët në sistem dhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

**Jon Simbert** – Kur shikoj formulimin, mendoj se qëllimi është i qartë, ku ne kërkojmë që gjyqtarët të kenë vetëm një imunitet funksional, i kufizuar nga çdo veprim i qëllimshëm korruptiv apo që i jep ndonjë lloj përfitimi. Kjo çështje lidhet me tre elementë: i qëllimshëm, miratimi dhe vendimi i paligjshëm që rezulton në: sjellje penale apo vepr penale, që duhet të jetë diçka që duhet reflektuar në Kodin Penal, interesi personal, që përbën konflikt interesi, apo keqdashja. Në ligjin anglez apo amerikan kjo nënkupton që ju po e bëni diçka në mënyrë që t'i bëni keq dikujt. Pra është diçka e qëllimshme. Të gjitha këto çështje kërkojnë dashjen, përveç interesit personal. Jam pak i shqetësuar lidhur me termin “vendim i paligjshëm”, sepse përndryshe këto gjëra do të ishin vendime të ligjshme, por që përsëri rezultojnë në personin që përfiton një interes personal.

**Fatmir Mediu** - Zoti Xhafaj, a mund të bëj një sugjerim?

**Arben Ristani** - Zotërinj, a mund t'ju pyes, kush e vendos që vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i paligjshëm? Cili e ndan që vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i paligjshëm? Është pyetje retorike, por ndoshta më jepni një përgjigje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Rainer Deville** – Vendimi në vetvete nuk është i paligjshëm. Sjellja e gjyqtarit, kur nuk e bazon gjykimin e çështjes mbi provat dhe faktet por në një rryshfet apo konflikt interesi është e paligjshme. Më pas kjo do të shqyrtohet nga gjykatat penale. Gjykata kompetente vendos nëse paraqisni provat që gjyqtari ka pranuar rryshfet.

**Fatmir Mediu** - Atëherë duhet të hiqet vendimi i paligjshëm.

Mënyra se si e konceptoj atë që thotë në anglisht z. Rainer dhe z. Xhon nuk ka të bëjë me thelbin e vendimit, por ka të bëjë me veprimin e gjyqtarit për të dhënë vendimin. Pra, nëse

do të përpiqemi t'i qartësojmë, sepse këtu në këtë nen thuhet: “vendim i paligjshëm”. Ky është konfuzion se kush gjykon vendimin dhe jo kush gjykon gjyqtarin. Ne duhet të sqarojmë që nuk gjykojmë vendimin, por gjyqtarët, sepse vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nuk i gjykon kush tjetër. Atëherë do të ishte shumë herë më mirë, përveçse rasteve të qëllimshme, të paligjshme në dhënien e vendimit.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë, që të kuptohemi ne shqiptarët dhe të mos i ngatërrojmë, duhet të kemi një gjë të qartë: e keni në Kushtetutën aktuale, e keni edhe këtu. “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij.” Ajo që është risi, që sjellim këtu ose që sjellin ekspertët është që nga ky rregull i përgjithshëm përjashtohet rasti kur ai ka marrë një vendim, i cili është i paligjshëm si pasojë e kësaj ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një sekondë!

Kur provohet, po marrim rastin kur kemi një aferë korruptive.

**Fatmir Mediu** - Po, por jo vendimin. Ky është problemi, nuk gjykon vendimin, por veprimin që çon te vendimi, sepse vendimin nuk e gjykon dot, apo jo?

**Fatmir Xhafaj**- Një vendim i marrë për shkak të korrupsionit, për shkak të një interesi, pa dyshim që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do ta gjykojë gjykata.

**Fatmir Mediu** - Më falni!

Zoti Xhafaj, po e bëj të thjeshtë.

**Fatmir Xhafaj** - Gjykata e ka marrë këtë vendim në kushtet që nuk ka pasur dijeni për këtë fakt, në momentin që zbulohen fakte të reja, zbulohet dhe veprimi i tij. Do të rishikojë vendimin patjetër, sepse ky është vendim i kundërligjshëm. Në momentin që ka marrë vendimin, ai është i rregullt, në momentin që është provuar që kjo ka ardhur si pasojë, ky është vendim i paligjshëm. Patjetër! Ta gjykojë gjykata kompetente. Në rastin konkret ai që do të provojë korrupsionin, do të provojë dhe vendimin. Kur është disiplinare, do ta gjykojë Gjykata Kushtetuese, kur është penale do ta gjykojë gjykata penale.

Në parim, jeni dakord të ketë një kufizim për imunitetin apo nuk doni ta ketë këtë, sepse nuk po të kuptoj?

**Fatmir Mediu** - Më falni!

Ta ketë, por çështja është se për çfarë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** - Po, ka për vendime. Nëse ti e lë në këtë mënyrë, do të thotë se pavarësisht se çfarë ka, nuk ka pasojë gjyqtari, sepse thotë që ky është vendimi im.

**Fatmir Mediu** - Zoti Xhafaj, a ka mundësi?

E para, nuk duhet të shtrojmë pyetjen: jemi apo nuk jemi, sepse jemi të gjithë për të njëjtin qëllim këtu. Ne duam të shmangim korrupsionin në çdo nivel të gjykatës dhe çdo influencë në vendimmarrje. Nga mënyra sesi e përkthej unë atë që shpjegoi Jon dhe Rainer, ne nuk gjykojmë vendimin si fillim, sepse vendimi si fillim nëse është për shkak paligjshmërie për fakte të reja mund të rikthehet në gjykatë. Nuk jemi ne, e çmon tjetërkush, ne gjykojmë veprimin e gjyqtarit, sjelljen jo të ligjshme të gjyqtarit, veprimin e paligjshëm të tij, qoftë në rastin e një vendimi të drejtë, qoftë dhe në rastin e një vendimi të padrejtë. Ai mund të marrë një vendim të drejtë dhe mund të bëjë korrupsion, mund të bëjë një veprim të padrejtë dhe përsëri të bëjë korrupsion. Në të dyja rastet është veprim i paligjshëm. Këtu është i gjithë shqetësimi që kemi ne. Nuk duhet ta rankojmë vendimin, por veprimin e gjyqtarit. Çështja e vendimit mendoj se mbetet në autoritetin e atyre që çmojnë: a ka fakte të reja për ta rishqyrtuar? Po e bëme kështu...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nëse do ta lëmë vendim të paligjshëm, ne mund të marrim në konsideratë çdo lloj vendimi të Gjykatës Kushtetuese, si të ligjshëm apo të paligjshëm edhe nga pozicionet tona politike.

**Fatmir Xhafaj** – Jo!

**Fatmir Mediu** - Kështu është. Hajde ta sqarojmë!

Gjyqtarin po, por jo vendimin. Si do të gjykosh vendimin?

**Jon Smibert** –Nëse flasim nga pikëpamja praktike është prokurori, i cili në Shtetet e Bashkuara, ka kërkuar heqjen e imunitetit të zyrtarëve dhe ajo që do të krijonit me fjalën “i paligjshëm” është një rreth nga i cili nuk do të dilni dot. Sepse do të më duhet të provoj së pari që imuniteti i këtij zyrtari është hequr, faktin që vendimi ishte i paligjshëm, duke provuar në këtë mënyrë veprimet e gjyqtarit me qëllim heqjen e imunitetit. Nuk keni nevojë të keni një fjalë të tillë. Kjo ngre një pengesë dhe nëse unë do te isha avokati mbrojtës, do të thoja që ju nuk keni

përcaktuar ekzistencën e një vendimi të paligjshëm sepse akoma nuk jemi në gjyq dhe nuk mund të shkojmë ende në gjyq për shkak se ai ka imunitet.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është për ta mbrojtur gjyqtarin.

**Rainer Deville** – Nëse e hiqni fjalën “i paligjshëm”, atëherë fjalia është më e qartë.

**Arben Ristani** – Çfarë do të provojë? Prokurori do të provojë se ti ke marrë ryshfet?

**Fatmir Xhafaj** - Edhe kjo ka ndikuar në vendim.

**Arben Ristani** - Dakord. Si e provon prokurori se vendimi është i paligjshëm?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** - Nëse ai mund ta shprehë, mund të ketë një konflikt interesi e të tjera dhe nuk ka influencuar në vendim...

**Arben Ristani** - Mirë, në rregull.

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me nenin 17, ndryshimi i nenit 127. “Mandati i gjyqtarit të gjykatës”. Keni ndonjë gjë?

Zoti Majko?

**Pandeli Majko** - Jam absolutisht dakord me të gjithë nenin siç është i formuluar, vetëm te pika 3 shprehja “sipas nenit 179”, paragrafi 1, mendoj se duhet të hiqet, pasi është i panevojshëm.

**Fatmir Xhafaj** - Cili?

**Pandeli Majko** – “Në rast se vendi i gjyqtarit mbetet vakant, organi përkatës”, shprehja “sipas nenit 179”, paragrafi 1 është e panevojshme. Kalon direkt: “Organi përkatës emëron gjyqtarin e ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit të gjyqtarit”. E sqaron ligji. Në këtë kuptim e ka besoj?

**Fatmir Xhafaj** - Pandi ka marrë pjesë edhe në Kushtetutën e parë.

**Oerd Bylykbashi** - Neni 17, që ndryshon nenin 127, është një nen që si rregull të paktën paragrafi i parë duhet të rregullojë mbarimin para kohe të mandatit. Futja në germën “b” që përfundon mandati 9-vjeçar, ndoshta ka detyruar të shkruhet: “Mbaron në rastet e mëposhtme”, por nuk duhet të ketë asnjë dyshim që nga rregullimet e dispozitave të mëparshme, mandati mbaron për 9 vjet. Nuk është kusht që duhet të jetë këtu. Nuk ka nevojë të shtohet. Është e tepërt, për ta pasur këtu.

E dyta, nëse do të qëndrojë, do të jetë ajo e para si germë, por unë besoj se germa “b” nuk duhet të qëndrojë fare. Kur një gjyqtar mbush moshën 70 vjeç, duhet të jetë e qartë, për

shembull dikush mund të aplikojë për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe të përzgjidhet edhe në një periudhë që është më e shkurtër se 9 vjet deri në arritjen e moshës 70 vjeçare. Nuk po them se ka kufi, por dikush mund të aplikojë në moshën 63 vjeçare. Pra, nuk duhet të jetë kusht për pengim të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, për kandidaturat për t'u përzgjedhur, fakti që e ka moshën më pak. Duhet të kemi kujdes, sepse po i delegojmë ligjit edhe kritere të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më kuptoni drejt. Thjesht për të qenë koherentë, do t'i delegojmë ligjit edhe kritere të tjera për zgjedhjen e anëtarit.

**Fatmir Xhafaj** - E ke sot në Kushtetutë.

**Oerd Bylykbashi** - Dakord. Ajo që po them është se ne do shkruajmë ligjin dhe kjo nuk duhet të na krijojë një kriter më poshtë.

Besoj se një nga arsyet më madhore për përfundimin e mandatit, më madhore sesa pensioni është kur anëtari vdes. Ky është një problem që mungon në të gjitha dispozitat e ngjashme në këtë draft. Mund ta marrim të mirëqenë, por fakt juridik është, përveçse ai fizik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord, por është një moment, që do të shprehesh proceduralisht. Të gjithë e dimë se edhe 70 vjeç mbushet në mënyrë kronologjike. Nuk kemi çfarë të bëjmë, aty do të shkojmë te 70- vjeçarët. Unë besoj që për të qenë koherentë, nëse do të heqim çështjen e mbarimit të mandatit që mbaron për nëntë vite. Bëhet fjalë për një dispozitë që rregullon mbarimin para kohe të mandatit.

Nuk e di, a do të vazhdojmë pikë pas pike apo t'i themi të gjitha? Në rregull. Te germa "e" e pikës 1, flitet për vërtetimin e faktit të pamundësisë për të ushtruar detyrën. Te kjo është e pakualifikuar, por besoj se një propozim me vend, dhe ajo që ne të gjithë besojmë, është pamundësia fizike apo mendore për të ushtruar detyrën. Pamundësia mund të jetë e pakualifikuar, mund të interpretohet në versione nga më të ndryshmet. Kështu, do të jetë e nevojshme për të bërë ndonjë saktësim të këtij lloji.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po nuk mund t'i lëmë në ligj këto gjëra. E kemi ne, Presidenti i Republikës, për pamundësi fizike, thotë Kushtetuta, nuk zëvendësohet nga tjetërkush.

**Fatmir Xhafaj** – Pamundësi fizike, mendore, e të tjera e të tjera.

**Oerd Bylykbashi** – Ç'të tjera? Këto të dyja janë.

**Fatmir Xhafaj** – Kuptohet, do ta sqarojë ligji këtë pamundësi, se s'mund ta vësh në Kushtetutë.

**Oerd Bylykbashi** – Megjithatë, ky është një sugjerim që...

Petrit Vasili – Unë mendoj, Oerd, se ky përcaktim është më komod, sepse, larg qoftë po themi, mund të ketë një problem shumë të rëndë familjar, një fëmijë a ku di unë se çfarë. Pamundësia mund të jetë gjithfarësh. Unë jam shumë dakord me fizike dhe mendore, është absolute, por ka edhe të natyrave të tjera, se kemi të bëjmë me njerëz të gjallë.

Kjo krijon një lloj hapësire më të gjerë, sepse jeta prodhon rrethana nga më të ndryshmet. Vetëm në këtë sens e kam.

**Oerd Bylykbashi** – Pra, në fund mbetet nevoja që ta disjelojmë në një masë. Në mos këtu, tek ligji duhet patjetër një disiplinim ngushtues, në mënyrë që të parashikojmë ato që janë të logjikshme, por jo një gjë që është e abuzueshme ndaj Gjykatës Kushtetuese.

Te paragrafi i dytë, mbarimi i mandatit të deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese, kjo do të na lidhet edhe me paragrafin e katërt. Po të vini re, ka një problem në lidhje me faktin e te paragrafi i katërt thuhet: “Brenda gjashtëdhjetë ditësh nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që ka deklaruar përfundimin e mandatit”.

Mirë, po Gjykata Kushtetuese kur e merr vendimin? Supozoni sikur, për një arsye që ne nuk e dimë tani, Gjykata Kushtetuese e merr me vonesë vendimin konstatues. Kjo mund të çojë në kapërcim të afatit të mandatit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, dakord, por a mund ta disjelojmë momentin e parë të pikës 2?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo, dakord, por e kam fjalën: a duhet të kemi kujdes për këtë?

**Fatmir Xhafaj** – Norma shikohet harmonike. Nuk shikohet e shkëputur, që unë e kam te pika 2, po pastaj s'e kam parë pikën 4. Ato janë harmonike. Ai fillon e numëron mbrapsht, që nga 60 ditë, kam 60 ditë, duhet të bëj këtë gjë, dhe ia dërgon Kuvendit.

**Oerd Bylykbashi** – Kryetar, unë besoj se për të dyja format që po themi, jemi në të njëjtën linjë logjike. Po e marrim të mirëqenë se kjo gjë do të rregullohet. Pra edhe momenti i nisjes, kur merret vendimi, do të rregullohet, por mund të ndodhë të mos rregullohet.

Pra, po e regjistrojmë këtu, sot këtë shqetësim, që ata të cilët do ta korrektojnë, duhet që edhe në pikën 2 të ketë një pikënisje, se cili është afati maksimal, brenda të cilit gjykata duhet të



bëjë këtë lloj konstatimi. Përndryshe kapërcejmë afatet, që parashikohen nga tërë neni e pastaj nga pika 4.

Çështje tjetër: në pikën 3 ka dy probleme. Së pari këtu flitet për organin përkatës. Përtej një diskutimi që ka zgjatur rreth një muaj, se cili është organi përkatës, për të emëruar anëtarin konsensual apo të KQZ-së, kushtetuese dikur, sepse nuk ndahej dot kuptimi i fjalës përkatës, unë besoj se ne duhet ta shkruajmë pak më qartë, se bëhet fjalë për organin e emërtesës. Diku tjetër është qartë. këtu nuk është. Pra, fjala “përkatës” duhet të zëvendësohet me terminologjinë që të çon te organi, i cili ka emëruar personin, anëtarin që po zëvendësohet. Në vend tjetër është më saktë. Pra, kërkon një lloj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në mos gabo, organi që ka emëruar anëtarin që zëvendësohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jua them nga praktika, zoti Xhafaj: kemi qenë të përfshirë të dy në atë kohë, më 2003, në këtë histori. Termi “përkatës” na bëri rrëmujë gati një muaj. Në vend tjetër është e saktë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithashtu, për ta mbyllur këtu, unë besoj se ne nuk mund t’u referohemi neneve transitore, në nj dispozitë të...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është hequr kjo? në rregull. Më fal! Të kërkoj ndjesë!

Për rrjedhojë, te pika 4, edhe referimi te afati ligjor, besoj se bën fjalë për afate kushtetuese, në rastin konkret dhe nuk bëhet fjalë për afate ligjore.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Dakord me këto?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem! Të lutem, të mos e bëjmë këtë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kur të vijë ligji, Vasilika.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çfarë pyetje ke, të lutem?

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje në lidhje me paragrafin e katërt, ku thuhet: “afati 60 ditë”. Brenda këtij afati është vendimi që merr Gjykata Kushtetuese. E dyta, afati që i lihet Këshillit të Emërimeve. Besoj se është afati që i lihet mbledhjes së përbashkët të Gjykatës së

Lartë dhe Gjykatës Administrative, për kandidatët e vet, dhe ne. Ky 60-ditshi a është i mjaftueshëm?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Këtë po pyes.

**Fatmir Xhafaj** – Po. Për ata që e kanë bërë, keni një afat të ri ju?

**Vasilika Hysi** – Jo. në qoftë se ju jeni në përbërje, i dini ligjet e tjera. për këto organet e tjera, a janë lënë afate?

**Fatmir Xhafaj** – S’e di. Kur të vijë këtu do ta shikojmë, se është duke u diskutuar në sallën tjetër.

**Vasilika Hysi** – Më fal, po nëse ne do të lëmë 60-ditshin këtu, duhet të jenë shumë të rakorduara me ata që...

**Fatmir Xhafaj** – Patjetër!

Faleminderit! E mbyllim nenin 117. Kalojmë te neni 18/ 128.

Po, zoti Majko.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, neni 128!

**Pandeli Majko** – Unë jam dakord me nenin 128, ashtu siç është formuluar, vetëm se te pika 1, në paragrafin e parë, propozoj që të hiqet shprehja “pa pjesëmarrjen e gjyqtarit subjekt i procedurës disiplinore”, pasi mendoj se kjo mund të jetë pjesë normale e shprehur në ligj, pjesë normale e ligjit. Pra, propozoj që pika 1 të jetë e formuluar: “gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore, sipas procedurës që rregullohet me ligj. Proçesi disiplinor ndaj gjyqtarit zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos për shkarkimin e tij, kur...” dhe vazhdon pastaj.

Mendoj se ky detaj që sapo thashë, i vendosur në pikën 1, mund të jetë komplet i implementueshëm në ligj. Nuk kam asnjë shtesë. Propozoj që, te pika 1 të hiqet “pa pjesëmarrjen e gjyqtarit subjekt i procedurës disiplinore”.

**Fatmir Xhafaj** – Po. A ka kush gjë tjetër për këtë nen?

**Vasilika Hysi** – Kam unë.

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje për ekspertët. Jam dakord që procesi disiplinor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, por a ka të drejtë gjyqtari që të dëgjohet? Pra, në rastin

konkret, a do të zbatohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut?

Pyetja e dytë ka të bëjë me përcaktimin që ju keni bërë, që formuluesit kanë bërë, në paragrafin e dytë të ligjit, pika “b”, ku thuhet se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra kur ai merr cilinë e të pandehurit, për një krim të rëndë të kryer me dashje. Cili quhet krim i rëndë i kryer me dashje? Në legjislacionin penal, ne nuk kemi një përcaktim se çfarë quhet krim i rëndë. Në direktivat e Bashkimit Europian quhet krim i rëndë çdo vepër penale, për të cilat parashikohet dënimi me katër vjet burgim e lart.

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem, për sa i përket procesit të rregullt ligjor të mos investojmë kot. Nuk mund ta mendojmë dot që të mos ketë një proces të rregullt ligjor në Gjykatën Kushtetuese për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër, do të dëgjohet. Vendimi merret nga gjykata. Po, pa tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do ta sqarojmë në ligj, prandaj e hoqëm si bëhet procesi e të tjera e të tjera.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është në trupin gjykues pra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, procesi zhvillohet nga gjykata, pa pjesëmarrjen e tij në gjykim...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E hoqëm këtë. Ju lutem, mos u kapni me detajet. Dolëm të gjithë konstitucionalistë. Dakord jam unë, por një çikë më modestë.

**Oerd Bylykbashi** – Gjithsesi, duke mbështetur edhe atë që thotë kryetari, që nuk mund të imagjinohet, por edhe duke pasur parasysh se çudira ka gjithmonë, mendoj se nevoja që ngre zonja Hysi është një nevojë që e shtrojmë edhe ne, për t’u qartësuar. Megjithatë, i mbetet punës për të mbyllur detajet e këtij formulimi këtu.

Lind edhe një problem tjetër: po flasim për procedurë disiplinore nga Gjykata Kushtetuese ndaj një anëtari, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në trupën gjykuese. Ka të drejtë

të marrë pjesë në gjykim, për shkak të procesit të rregullt ligjor, për të mbrojtur të drejtat e tij. Kështu, nga një trupë me nëntë anëtarë, do të gjykohet me tetë anëtarë.

Rezultati i një procedimi disiplinor është shumë i rëndësishëm edhe për publikun, apo jo?

**Fatmir Xhafaj** – Po, po.

**Oerd Bylykbashi** – Ç’do të ndodhë kur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Domethënë, rrëzohet procedimi...?

**Fatmir Xhafaj** – Pse pyesni, kur e dini vetë përgjigjen? Ju jeni mjeshtër.

**Oerd Bylykbashi** – Dakord, pra, dakord! Tani, ne këtu e kemi për detyrë të themi dy gjëra, që ata që do ta marrin ta lexojnë këtë që po themi ne, të dinë edhe çfarë do të zbardhin. Nuk po e them si një çështje që do ta zgjidhim këtu.

**Fatmir Xhafaj** – E dhe vetë përgjigjen.

**Oerd Bylykbashi** – Dakord, pra, por nganjëherë do të mbeten gjëra të pathëna, nganjëherë ndodh edhe që janë të pabëra, kryetar, kështu që të kuptohemi drejt. Të themi ato që kemi për të thënë, pa u zgjatur shumë, dhe ta mbyllim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, vetëm se konciz, ju lutem!

**Oerd Bylykbashi** – Ndërkohë, në lidhje me germën “b” të pikës 2, ne duhet të kemi një qasje unike. Në qoftë se Parlamenti i Shqipërisë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të doja vëmendjen e kolegëve, sepse besoj se është diskutim që ka rëndësi.

Në qoftë se ne, para pak kohësh, rrëzuar një amendament në një ligj, i cili do të pengonte pezullimin nga detyra të një funksionari publik, për shkak të arrestit në flagrancë, pra jo arrestit si masë sigurie, për një krim ndaj jetës apo shëndetit, këtu po e ulim nivelin. Po themi se mjafton që dikush të marrë cilësinë e të pandehurit, gjë të cilën e vendos prokurori, në germën “a” ndërhyr gjykata, e cila i jep masën e arrestit me burg apo arrest shtëpie. Pra, ka parë edhe dy prova gjykata.

Në rastin e marrjes së cilësisë së të pandehurit, kjo është në dorën e prokurorit, i cili, ashtu si Gjykata Kushtetuese, mundet të marrë një vendim, pra ta bëjë këtë procedim për një interes personal, me keqdashje apo edhe duke kryer një vepër penale. Ka nisur apo ka marrë të

pandehur një apo me shumë gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke handikapuar një vendim të caktuar apo duke kolapsuar gjykatën, sepse mbrojtja është as minimale.

Prokurori mund të shpikë çfarëdolloj gjëje, ose nga paaftësia shpik diçka, që ai s'e ka kuptuar se ç'po bën. Që ai të quhet krim i rëndë, duhet të materializohet me vendim përfundimtar të formës së prerë. Pra, nëse te germa "a" kemi një minimum garancie, që është vendimi i gjykatës për masën e arrestit, këtu nuk kemi asnjë garanci më.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë: nuk kemi as atë. Refuzuam arrestin në flagrancë, por një vrasje apo plagosje, dhe këtu themi: për më pak se kaq, ne boll ta regjistrujmë, dhe mund të arrijmë që një anëtar, dy e deri në nëntë anëtarë, t'i pezullojmë nëpërmjet një procedure eventualisht të korruptuar politikisht.

**Fatmir Xhafaj** – Po, dakord!

**Oerd Bylykbashi** – Këtu bëhet fjalë për krim korrupsioni apo krim të organizuar, ku na hyn në lojë SPAK-u me Byronë Kombëtare të Hetimit. Bëhet fjalë për një krim të rëndë, që s'është objekt i punës së tyre, i pavarësisë së tyre. Mund të jetë prokuroria normale ajo që e nis...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po le të supozojmë se SPAK-u nuk do të gabojë, sepse ia kemi dhënë këtë investiturë kaq të madhe SPAK-ut. Po nëse një prokuror i zakonshëm, i cili po ndjek një çështje të një krimi të rëndë dhe merr të pandehur gjysmën e Gjykatës Kushtetuese, çdo të bëjmë?

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

Ta jap unë përgjigjen, që të mos investojmë fare ata? Lexojeni me vëmendje! Pika 2: "Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pezullohet nga detyra". Po e ndërpres këtu. Sipas pikës "a" dhe pikës "b", "me vendim të Gjykatës Kushtetuese".

Pra, i bie jo një prokuror i çmendur, por një Gjykatë Kushtetuese e çmendur. Pra, Gjykata Kushtetuese i thotë prokurorit: "Po, mor zotëri, e ke marrë të pandehur, por nuk është në këto kushte dhe unë nuk e pezulloj atë".

Madje, ti i ke dhënë të drejtë Gjykatës Kushtetuese, që ta gjykojë edhe kur është siguruar masa e arrestit personal. Është vendimi i vetë Gjykatës Kushtetuese.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, ju sapo ekspozuat një debat që e kemi bërë në vitin 2014. Në vitin 2014, me një propozim të maxhorancës, u ndryshua ligji për KLD-në, që e detyronte KLD-në të merrte vendim, në dukje diskrecion, për të pezulluar një gjyqtar, i cili qe

marrë i pandehur. Në interpretimin që bëre atëherë nga maxhoranca, ai do të ishte një vendim formal. Ndoshta edhe këtu jemi para së njëjtës situatë, ku gjykata është e detyruar nga teksti i Kushtetutës, që ta marrë këtë vendim sepse ka ndodhur ky fakt. Nuk jemi përpara mundësisë për ta marrë, pra, çmimit nga Gjykata Kushtetuese, nëse duhet at bëjë këtë apo jo.

Kësisoj, unë besoj se duhet të kemi kujdes te kjo pjesë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull!

Besoj se do ta shikojë edhe vetë gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese... Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që janë shprehur në atë procesverbal që kam lexuar unë, nuk kanë pasur vetë kontestim. Gjithsesi do të kenë rast...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zoti Rainer, ju lutem!

**Rainer Deville** – Me sa më kujtohet, në sistemin tuaj askush nuk dërgohet në paraburgim pa vendimin e gjyqtarit, kështu që nuk është aq e lehtë që prokurori të vendosë vetëm. Ekziston gjithnjë një gjyqtar, i cili duhet të ketë faktet dhe provat për kryerjen e një veprë të rëndë penale. Prandaj, nuk është aq e thjeshtë sa mendoni.

Procedurat disiplinore normalisht shkojnë përtej kësaj. Madje duhet të fillojnë kur dikush nuk është akuzuar apo pretendohet si i pandehur, pra edhe përpara se të ngrihet akuza; dhe nëse hetimi disiplinor për një veprë të rëndë penale ka filluar dhe bazohet mbi arsye objektive të përcaktuar në ligj, atëherë edhe sanksioni disiplinor, dhe pezullimi ndodh më parë. Ajo që ekziston në draft është dhe parashikimi i kësaj faze të sanksioneve disiplinore. Ajo që keni ju këtu, është tepër e vonë për një gjë të tillë. Kështu që nëse e shikoni në nivel eksperti masa disiplinore, do të shkonte në drejtimin e kundërt. Pezullimi duhet të fillojë edhe më herët, dhe mendoj se nëse e keni në këtë mënyrë atëherë jeni pak me vonesë për sa i përket pezullimit.

**Jon Simbert** – Edhe sipas pikëpamjes sime, në paragrafin 2 unë shoh mundësinë që Gjykata Kushtetuese mbron veten nga gjykimet mbetet i vlefshëm në mendjet e njerëzve, sepse nuk do të ketë dikë që akuzohet për vepra të rënda penale që të marrë vendime. Dikush ndaj të cilit është caktuar arresti në shtëpi apo ndonjë masë tjetër, në shumë vende do të konsiderohej si i papërshtatshëm që ai gjyqtar të marrë vendime kur ai është akuzuar p.sh. për vrasje apo ndonjë krim tjetër të rëndë. Nuk është thjesht çështje disiplinore, por gjithashtu Gjykata Kushtetuese duhet të mbrojë vendimet e veta.

**Oerd Bylykbashi** – Unë ndaj të njëjtin mendim me zotin Smibert. Me siguri, ky është qartazi një instrument për të mbrojtur Gjykatën Kushtetuese, por mënyra si do ta shkruajmë mund të na çojë në një drejtim tjetër. Prapë Gjykata Kushtetuese mbetet, por nëse interpretimi do të jetë se ky është një rregullim detyrues për gjykatën, pra jemi përpara një vendimi thjesht për ta marrë, sepse kushtet janë përmbushur, mund të kemi problem.

Një pyetje kisha unë. E kam gjithmonë te “a”-ja. Për të dy ekspertët, por ndoshta më shumë për zotin Deville. E para: cili është një model i ngjashëm, në sisteme ligjore solide, që ka këtë rregullim, pra germën “b” të pikës 2?

Së dyti: një vendim i Gjykatës Kushtetuese për pezullim të një gjyqtari që është marrë i pandehur, do ta rëndonte atë më shumë? Pra, nëse është menduar si mbrojtje, si dispozitë.

Marrja e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese për një person që prezumohet i pafajshëm, do t’ia rëndonte më shumë pozitën atij, jo vetëm pozitën publike, por edhe para gjykatës normale, e cila po shqyrton procedimin? Çfarë garancish i krijohen personit në lidhje me prezumimin si i pafajshëm?

**Rainer Deville** – Sipas skenarit të parë kjo është e zakonshme. Mua më kujtohet, madje, edhe në gjykatën time, që nuk ishte Gjykatë Kushtetuese në atë kohë, që një gjyqtar i akuzuar penalisht, u largua menjëherë. Sigurisht që kjo nuk është as pyetje pasi gjyqtari duhet të largohet. A është ky vendim? Sigurisht që jo. Ne flasim jo vetëm për pezullim nga detyra. E vetmja gjë që mund bëni është që të prisni dhe të mos përfshiheni. Ju prisni dhe lejoni që të kryhen procedurat. Nëse jeni i pafajshëm, në rregull, jeni i pafajshëm. Kjo nuk ka asnjë ndikim në rezultatet e hetimit, dhe kuptohet që largoheni vetëm për këtë periudhë. Kjo është një praktikë e përhapur europiane dhe çdokush që është jurist dallon midis kësaj mase dhe pret – nuk ka asnjë paragjykim. Është një pasojë normale. Është një masë standarte që kemi, nuk ka asnjë arsye të shqetësoheni. Nëse nuk e keni, atëherë duhet të shqetësoheni. Komisioni i Venecias është treguar mjaft alternativ lidhur me këtë lloj pyetësori dhe pajtohet plotësisht.

**Oerd Bylykbashi** – Më duhet ta sqaroj këtë pikë. Unë nuk dua të zgjatem, por është shumë delikate. Unë kërkoja modelin dhe praktikën e dorëheqjes, e pranoj ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Edhe unë do të marr pjesë në interpretimin e asaj që thotë Komisioni i Venecias, që ta shkruajmë këtu. Pra, duhet një model solid. Ku ka? Unë e di që eventualisht, duhet të japë dorëheqjen një anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Nuk e pranoj idenë e vetëpezullimit, sepse duhet të

jetë normë kushtetuese, por më shumë e kam për germën “d”. Nëse kjo është menduar të jetë dispozitë mbrojtëse e Gjykatës Kushtetuese, a kemi një model të shkruar, jo praktik?

E dyta, unë besoj se një vendim i Gjykatës Kushtetuese ia rëndon pozicionin, pjesën subjektive të gjykimit para një gjykate dhe opinionit publik. Mund të çohet dikush dhe të bëjë edhe protestë. Ne duhet t’i evitojmë maksimalisht këto gjëra. Na duhet një gjyqtar, që të mos ta infektojë eventualisht, edhe imazhin e Gjykatës Kushtetuese.

Nga ana tjetër, duhet të bëjmë kujdes që të mos shkojmë në masa aq ekstreme, që cenojnë edhe gjykatën, edhe të drejtat e këtij individi, se këtu po flitet për të drejtat e këtij individi, para një gjykate penale. Jemi duke ia rënduar njësoj, sikur ta fusim një person prapa hekurave të gjykatës, ndërkohë që ai është i pafajshëm. Kjo gjë që për shembull, në SHBA apo në një vend tjetër, nuk ndodh. Edhe një kriminel nuk gjykohet pas hekurave. Kështu që ne nuk duhet të shkojmë më larg me partizanllëqe (e thënë shqip), në këtë aspekt. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të marrë vendim (duhet të jetë e qartë që ka të drejtë të marrë vendim dhe nuk është e detyruar). Ne nuk do të ulim barrierat e fundme për sa i përket të drejtës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për të qëndruar në detyrë, ndërkohë që prezumohet i pafajshëm.

Deputetit ia heqim me të njëjtën gjë, kur është i dënuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Pa u dënuar, kur ka masë sigurie, që e ka vlerësuar gjykata.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Zoti kryetar, nuk po flas për germën “a”, por po flas për germën “b”. Të del një prokuror shumë i zellshëm, i cili të bën kërdrinë te Gjykata Kushtetuese.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

E shkruar kështu siç është, nuk është e qartë që është në diskrecion të gjykatës për t’u mbrojtur, pra mund të dalë një gjykatë dhe të thotë që është e detyruar ta marrë këtë vendim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Maxhoranca e Gjykatës Kushtetuese eventualisht do që të mos ta ketë një anëtar të saj in aty. Cilat janë garancitë që ka ky anëtar për të shërbyer atje, sepse del rregullisht në minorancë?

**Fatmir Xhafaj** – A ka garanci më të madhe në këtë vend, sesa vetë Gjykata Kushtetuese?

Ne i kemi dhënë Gjykatës Kushtetuese të drejtën të interpretojë Kushtetutën, aktin themeltar të shtetit, të shikojë ligjet e Kuvendit dhe nuk i japim besimin të gjykojë anëtarin e vet?



Ky është maksimumi i mbrojtjes që mund t'i japim. Të gjithë ne jemi të ekspozuar dhe shkojmë para Gjykatës Kushtetuese dhe besoj se ky është maksimumi. Unë po ta kisha në dorë, do ta bëja automatik pezullimin. Dakord, i ka dhënë një mbrojtje për arsyen që thatë ju. Ky është maksimumi, është ekstremi i mbrojtjes.

**Oerd Bylykbashi** – Pra, kjo është një histori qartësimi. Le të punojmë mbi të, që të mos ta zgjasim.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Atëherë, biem dakord për nenin 128, me ndryshimin që u tha. Neni 130 ndryshohet, si më poshtë vijon.

Urdhëroni, zoti Majko!

**Pandeli Majko** – Unë mendoj se neni 130 është formuluar shumë mirë. Në fakt, edhe ashtu siç ka qenë, ka qenë i formuluar shumë mirë, por kjo shtesa “shkencore”, pra “me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik dhe shkencor”, qëndron. Nëse një gjyqtar, i cili në profesionin e vet, në *background*-in e vet është jurist i Gjykatës Kushtetuese, dhe do që të japë koncert apo të bëjë ndonjë ekspozitë, nuk besoj se është e nevojshme ta vendosim në Kushtetutë. Ai është i lirë ta bëjë dhe besoj se nuk ka asnjë ndalim ligjor dhe të jetë kaq e rëndësishme që ne ta vendosim në Kushtetutë. Jam dakord të vendoset: “dhe shkencor”, por kjo: “dhe artistik”, është e tepërt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ai është biznes, nuk është veprimtari artistike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Në çdo rast, mendoj që hyn te momenti akademik dhe shkencor.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Dakord, por unë mendoj që: “dhe artistik”, është e tepërt.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Mendoj se po flasim për hobi.

Jo, ju lutem! Kështu siç është e shkruar këtu, nuk është veprimtari biznesi fitimprurëse. Kjo është hobi dhe mbetet hobi. Hobi në nivel kushtetues, më duket i tepërt.

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar,

Unë kam dy sugjerime.

E para, mua më duket që formulimi i nenit 130, siç është në Kushtetutë është më i plotë, më i qartë. Ne mund të shtojmë diçka dhe neni 130 të lexohet si më poshtë:

“Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor dhe artistik.”

E bëj këtë sugjerim për shkak se fjalia e dytë dhe e tretë, që janë shtuar në projektligjin për ndryshimet kushtetuese, është përsëritje e pjesës së parë të këtij neni, ku thuhet që qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, profesionale etj.

Nga ana tjetër, nëse do ta lëmë fjalinë e fundit ose formulimin që është këtu, në projekt, me të drejtë mund të lindë pyetja: Cilat janë veprimtaritë e tjera të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, përveç atyre që janë përmendur në fjalinë e parë dhe të dytë, që janë: veprimtaria shtetërore, private, profesionale dhe politike? Ndaj, sugjerimi im për ta pasur sa më fine gjuhën, është të futet te formulimi që është aktualisht në nenin 130 të Kushtetutës, duke shtuar paragrafin: “me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor dhe artistik.” Çdo lloj veprimtarie tjetër bie ndesh me Kushtetutën.

**Fatmir Xhafaj** – Kush ka ndonjë gjë tjetër?

**Oerd Bylykbashi** – Kam përshtypjen që fakti që ne përmendim dy herë mospajtimin ose papajtueshmërinë (e kemi edhe në fillim edhe në fund), kur themi: “Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër ...”

**Fatmir Xhafaj** – Keni ndonjë propozim, si mund ta përmbledhim?

**Oerd Bylykbashi** – Po, do ta them. Këtu nuk pajtohet qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese me asnjë veprimtari tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Si mund ta përmbledhim?

**Oerd Bylykbashi** - Po, se këtu nuk përcaktohet se cilat janë papajtueshmëritë e tjera. Ne mund ta themi që në fillim, që janë papajtueshmëri të përcaktuara me ligj.

Edhe elementi që nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti, te kushtet për t’u emëruar gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, kufizimi është qenia në funksione drejtuese në dhjetë vitet që paraprijnë emërimin si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Nëse në këto dhjetë vjet që paraprijnë, dikush ka pasur funksione drejtuese në një parti politike, nuk mund të emërohet.

Aty nuk përmendet anëtarësia. Në momentin kur emërohesh, del menjëherë te kjo dispozitë, pra ose kjo duhet të jetë diku tjetër, ose kjo nuk duhet të jetë fare këtu. Pra, do ta çojmë ndalimin deri në atë pikë. Pse është kjo shkëputje? Ndoshta mund të na shpjegojnë ekspertët.

**Vasilika Hysi** – Në fakt çështja që ngrini ju, ka dy probleme të ndryshme.

E para, është një kriter që një person nuk mund të bëhet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, pra të jetë kandidat, nëse në dhjetë vitet e fundit ka qenë në politikë.

E dyta, është që, në momentin që një person është kandidat dhe zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese, ai nuk mund të jetë as anëtar i një partie politike, as nuk mund të marrë pjesë në veprimtari të organizuara nga një parti politike që mund të jenë manifestime, tubime dhe protesta, sepse edhe kjo është veprimtari politike dhe kjo është e ndaluar edhe në Kushtetutën aktuale (neni 130). Njëkohësisht, ai nuk mund të kryejë edhe veprimtari të tjera shtetërore. Risia që sjell projekti, është që e specifikon se çfarë i lejohet. Propozimi që kanë sjellë ekspertët e nivelit të lartë, më duket shumë i drejtë: i lejohet aktiviteti mësimdhënës, akademik, shkencor dhe artistik.

Meqenëse kolegu Majko ka shqetësim për veprimtarinë artistike, unë do të thosha që kemi sot gjyqtarë që kanë botuar jo vetëm vepra të nivelit mësimor dhe shkencor, ku përmbledhin përvojën e tyre si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, por ata mund të bëjnë një roman dhe ai roman ka të ardhura dhe ato të ardhura deklarohen dhe këtë nuk mund t'ua ndalosh. Ne kemi një koleg të prokurorisë (të mos përmend emra), që ka bërë një roman për vrasjen e Falkones. Duke qenë prokuror, ai ka ngritur indirekt edhe probleme që lidhen edhe me procesin në Shqipëri, por ai ka bërë të ardhura nga shitja e atij libri dhe ka disa detyrime edhe te tatimet, edhe për ta deklaruar si burim fitimi. Atëherë, botimi i një libri artistik është veprimtari artistike. I bie që ai të mos marrë pjesë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Më falni, zoti Mediu!

Shkolla e Magjistraturës bën aktivitete të ndryshme në Ditën e Drejtësisë, në 10 maj. Midis tyre bën edhe një gjyq imitues, por mund të ketë edhe aktivitete të tjera që nuk janë të mirëfillta të tilla, mësimore-didaktike. Mund të ketë edhe aktivitete që kanë karakter mësimor-formues-trajnuar në aktivitete artistike, i bie që sapo të fillojë pjesa artistike-kulturore, gjyqtarët të largohen, sepse nuk duhet të jenë pjesë. A e kuptoni se çfarë mund të ndodhë?

**Fatmir Mediu** – Edhe një gjë tjetër. Unë mendoj që të patën, po të merren me veprimtari artistike, do të lehtësohen pak nga mënyra se si qasen me problemet. Nuk kemi pse t'i përjashtojmë. Pjesa e veprimtarisë artistike, mendoj se është futur. Megjithatë unë do t'i kthehem çështjes së parë që ngriti Oerdi, jo për ta trajtuar në atë këndvështrim se përse nuk parashikohet që të jesh politikan dhe të jesh, edhe anëtar i Gjykatës Kushtetuese për 10 vjet dhe ndalimi, kur je anëtar kur e ushtron funksionin.

T'i themi disa gjëra siç janë. Ne vijmë nga një shoqëri problematike për 45 vjet. Ne mendojmë të drejtën e klasës së re politike për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ia lejojmë këtë një pjese, e cila mund të ketë pasur shumë më tepër ngarkesa politike, edhe në kuptimin e të drejtave nga sistemi i vjetër.

Ka edhe një element të dytë, që duhet ta shikojmë me vëmendje shumë të madhe. Ne nuk jemi shoqëri kaq e madhe dhe nuk është se në këto 25 vjet, të kemi formuar një kastë të shquar intelektuale, se po flasim për kualitetin e jurisprudencës. Padyshim, edhe përzgjedhja do të jetë në këtë pullë, të këtyre marrëdhënieve, që ne njohim. Aq më shumë, po të shikohet mënyra si do të veprohet për emërimin dhe përzgjedhjen e tyre.

E treta, që dua të them, e thashë edhe më parë kur po e diskutonim: Ç'është kjo ndjesi? Për shembull, Fatmir Xhafaj dhe Oerd Bylykbashi qenkan të zotët të bëjnë ndryshime kushtetuese dhe qenkan të papajtueshëm për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese?! Për mua është një përjashtim alogjik, sepse integriteti i personit nuk ka të bëjë me faktin se ka qenë apo nuk ka qenë në politikë dhjetë vjetët e fundit. Si jashtë politikës, edhe brenda saj, ka të bëjë me integritetin personal të atij që merr përsipër një detyrë për ta ushtruar atë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin. Unë ua kam thënë edhe kolegëve të mi. Këto përjashtime janë si një lloj harakiri që e bën klasa politike për të thënë: shiko, se ne jemi e keqja e madhe dhe nuk ka nevojë që të ketë nga ne. Kjo është nonsens, është një mosvlerësim dhe kur ne arrijmë në një lloj mosvlerësimi të klasës politike, çfarë ndryshimi presim? Ka njerëz me integritet, që kanë qenë pjesë e politikës, kanë qenë në parlament dhe është një investim i kësaj shoqërie, që të mund të jenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese apo të niveleve të tjera të gjyqësorit? Pa dyshim, ka.

Nëse do ta bëjmë këtë përjashtim, anglezi ka një shprehje: “Budallai i urtë, numërohet për i mençur”. *“Even a fool, if he stays silent, is counted wise man.”*

Unë nuk përfitoj nga kjo, se nuk jam jurist dhe nuk pretendoj ndonjë gjë. Çështja është se nuk mund t'ua heqim një të drejtë disa njerëzve, që kanë kualitetin për të qenë atje. Është një

përrjashtim që bëhet thjesht, për shkak të rrethanës së perceptimit dhe jo për shkak të realitetit, se çfarë duam të ndërtojmë në Gjykatën Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – I përmbylim diskutimet për këtë nen?

Urdhëroni zoti Rainer!

**Rainer Deville** – Dua t’ju tërheq vëmendjen se kemi të njëjtin formulim për nenet 143, 147/ ç dhe 148/d ku bëhen edhe përsëritje për të tjerat. Deri më tani, po ta ndryshoni këtu, atëherë duhet të ndryshohet edhe në pjesët e tjera. Ajo që mund të konsideroni të shtoni, për të paktën njerëz të tjerë, është lejimi i një veprimtari tjetër që mund të jetë komandimi, kur shkojnë në funksione të ndryshme për një periudhë kohore. Kjo mund të ndodhë edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në nivel ndërkombëtar. Mendoj se duhet të lejojmë një komandim të tillë në fushën e drejtësisë edhe nëse paguhet si përrjashtim nga detyrat. Nëse dëshironi, në nenin 130, në pjesën e dytë nga fundi ku keni përmendur “si edhe veprimtari të tjera që nuk janë në përputhje me detyrat”, kjo është një klauzolë e përgjithshme. Nëse nuk ju pëlqen kjo ide, ndoshta mund ta fshini ose shkurtoni pak, por do të ishte edhe një formulim i mundshëm edhe nëse e hiqni pasi nuk lë hapësirë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, meqenëse edhe ju e ripatë, atëherë ka nevojë për t’u rishkruar, për t’u sistemuar, për të qenë më konciz. Ky është kuptimi.

Ju falënderoj!

Neni 20.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon).*

Për nenin 20?

Dakord, urdhëroni!

**Fatmir Mediu** – Për nenin 20, kam një shqetësim në themel. Për fat të keq, kemi jo pak histori që bazuar mbi këtë koncept, që besoj se jemi përrpjekur ta përcaktojmë qartë, por mendoj se duhet të jetë akoma më i qartë, ndodh që Gjykata Kushtetuese të kthehet në një gjykatë të nivelit të katërt. Çështja është që ne nuk mund të pranojmë që 3 shkallët e gjyqësorit të shoqërohen me një shkallë tjetër të gjyqësorit. Nuk kanë ndonjë përcaktim specifik se rasti i të drejtës, si do të përcaktohet se cilat raste do të gjykohen nga Gjykata Kushtetuese. Ndoshta eksperiencia e ndonjë vendi tjetër mund të na vlejë, por ato janë dosje gjyqësore të gjykimit të Gjykatës së Lartë, të cilat çohen në Gjykatën Kushtetuese për t’u rikthyer për gjykim, e kështu me radhë, duke krijuar kështu një proces të tejzgjatur dhe të pambyllur juridikisht, i cili krijon

një kosto shumë të madhe dhe padyshim, një angazhim të Gjykatës Kushtetuese tej kompetencave të saj, sipas mendimit tim.

Shqetësimi im është ky: si do ta bëjmë këtë gjykatë që të jetë Gjykatë Kushtetuese dhe jo një gjykatë të nivelit të katërt? Prandaj, përcaktimi i rasteve në raport me të drejtën, duhet të jetë shumë specifik.

**Rainer Deville** – Ndoshta mund të përgjigjem menjëherë, sepse e kemi pasur këtë pikë që në fillim të nenit 124, paragrafi 2. Nëse thoni në nenin 124, paragrafi 2 që Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm aktet ligjore në kundërshtim me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, atëherë qartësoni se kjo nuk është gjykatë e shkallës së katërt. Interpretimi aktual i doktrinës ligjore në vend nuk respektohet, dhe ndoshta nuk respektohet pasi formulimi nuk është i qartë. Mendoj se ky do të jetë pozicioni ku ju mund ta bëni të qartë për të gjitha veprimtaritë e Gjykatës Kushtetuese se nuk duhet të thërrasin dëshmitarë. Unë mendoj se ky vendi më i përshtatshëm ku dispozita e përgjithshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ... (*mungon audio*)

**Pandeli Majko** – ....Çdo akti të pushtetit publik që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë”. Kjo përfshin edhe vendimet e gjykatave dhe mendoj se e bën më të qartë këtë pozicion të Gjykatës Kushtetuese. Propozoj të hiqet fjalia “vendimet gjyqësore dhe akteve të pushtetit publik që cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë”, e cila zëvendësohet me paragrafin që sapo citova.

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** – Unë kam vetëm një pyetje: propozimin që bëri zoti Rainer, që mua m’u duk i drejtë dhe pajtohem absolutisht me atë që tha edhe zoti Majko, a do ta shtojmë në Kushtetutë dhe te marrëveshjet ndërkombëtare, se e lidhim me nenin 124? Mos duhet ta shikojë grupi i ekspertëve këtë propozim?

**Fatmir Xhafaj** – Po, e kaluam atë.

**Vasilika Hysi** – Po lidhet kjo. Reformulimi që bëri zoti Majko më duket konciz, më i drejtë dhe më përfshirës që gjykata të punojë vetëm në këndvështrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë dhe në marrëveshjet e ratifikuara nga Shqipëria.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, biem dakord me nenin 20.

Neni 21.

Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, besoj se edhe Komisioni i Venecias e ka konsideruar një çështje komplekse këtë pengim që i bëhet Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar ndryshimet kushtetuese. Unë e kuptoj që është një tentativë për të mbrojtur ndryshimet, por kjo nuk mund ta kufizojë Gjykatën Kushtetuese për të bërë një minimum kontrolli. Edhe vetë Komisioni i Venecias ka thënë që Gjykata Kushtetuese duhet të ketë mundësinë së paku për të kontrolluar procedurën kushtetuese të miratimit të këtyre amendamenteve, pra të jetë një procedurë e parashikuar nga Kushtetuta dhe më pas të jetë e detajuar më tej në Rregulloren e Kuvendit, që, sigurisht, është garancia për atë që miratohet. Ne gjykojmë, gjithashtu, se është me rëndësi që Gjykata Kushtetuese të ketë mundësinë t'i mbrojë të gjithë nga vendimi që marrim ne si Kuvend, nga një ndryshim kushtetuese i qëllimshëm ose jo, i cili do të çonte në një përplasje të rëndë me parimet themelore, që janë në pjesën e parë të Kushtetutës, të cilat shkojnë përtej një formulimi kushtetues, por janë të shprehura në dokumente ndërkombëtare, të cilat ne nuk mund t'i anashkalojmë. Kështu që, përveç asaj që është kontrolli i procedurës, besoj se Gjykata Kushtetuese duhet të ketë mundësinë për të verifikuar nëse ndryshimet kushtetuese shkelin rëndë parimet e Kushtetutës, të cilat janë të përcaktuara në pjesën e parë të saj. Sigurisht, në momentin kur ne do të bëjmë detajime, kemi edhe formulime konkrete në lidhje me këtë, por besoj se kjo është diçka që duhet të merret në konsideratë. Të mos u hyjmë shembujve se cilat mund të jenë parime. Kushtetuta mund të vendosë gjëra që mund të cenojnë të drejtën e pronës apo të drejtën e jetës. Ne lajthisim dhe bëjmë diçka që nuk përputhet me parimet. E miratojmë, sepse kjo është konvergjenca politike e një momenti të caktuar. Mora dy shembuj ekstremë, por Gjykata Kushtetuese duhet të ketë mundësinë për ta mbrojtur shoqërinë nga ndryshimet që bien ndesh me parimet.

**Pandeli Majko** – Dua të shprehem pro nenit kështu siç është formuluar. Në parim si logjikë, nisur nga ajo që tha zoti Oerd, mund t'i sjell si shembull, jo në sensin ironik, ligjin e dekriminalizimit, ku ne, si parlament, kemi rënë dakord që ta kufizojmë të drejtën e zgjedhjes. Madje, kemi arritur edhe deri aty sa të themi edhe publikisht se do të biem dakord të mos shkojmë në Gjykatën Kushtetuese. Mendoj se ky është një nen, një paragraf i rëndësishëm, për të treguar faktin se Shqipëria është një Republikë parlamentare dhe kjo duhet nënvizuar. Gjithsesi,

rastet ekstreme që ju përmendët nuk besoj se e godasin kontekstin e paragrafit, prandaj shprehem pro tij.

**Fatmir Xhafaj** – Vetëm se ka një gjë për të cilën duhet të jemi fare të qartë: kjo është një çështje fort e debatueshme. Është debatuar në nivel ekspertësh, është debatuar ndërmjet ekspertëve edhe në konsultimet publike dhe për herë të parë hedhim një hap duke i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të shikojë procedurën. Procedurën e miratimit të amendamentit kushtetues nuk e shqyrtonte më parë Gjykata Kushtetuese. Për këtë është bërë një diskutim shumë i vëmendshëm nga Komisioni i Venecias. Në të dyja opinionet e Komisionit të Venecias ka pasur një angazhim të drejtpërdrejtë për ta qartësuar këtë gjë dhe ka qenë shumë e qartë dhe pa asnjë ekuivok kur ka thënë: “E shumta që mund të bëhet, por ngelet në dorën tuaj, është çështja e procedurës”. Çështja e thelbit nuk është standard, por edhe nuk mbështet. Nuk dua t’i hyj debatit se çfarë mund të ndodhte në këtë vend nëse një norme kushtetuese, që ishte vendosur nga ligjvënësi apo me referendum, do të kishin mundësi ta hidhnin poshtë nëntë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.

**Oerd Bylykbashi** – Në fakt, Komisioni i Venecias thotë: “Do të ishte e mundur t’i jepej Gjykatës Kushtetuese jo shumë, por të paktën pushteti për të verifikuar procedurën me të cilën janë miratuar amendamentet kushtetuese”; ky është minimumi. Ndërkohë, ajo që po themi në është mundësia për të verifikuar edhe shkeljen e rëndë të parimeve dhe, nëse ne do ta bëjmë këtë, do të jemi plotësisht brenda asaj që na lejon Komisioni i Venecias, pra “të paktën” do të thotë edhe më shumë se kaq. Nëse ne nuk do ta bëjmë këtë gjë dhe nëse me konsensusin tonë të përbashkët do të miratojmë dispozita që do të kolizionojnë me parimet e parashikuara në Kushtetutë, në dispozita të tjera, do të jemi përpara mundësisë ku do të kemi përplasje të normave kushtetuese me pamundësinë e Gjykatës Kushtetuese për të ndërhyrë dhe për ta zgjidhur këtë çështje. Më pas Gjykata Kushtetuese do të detyrohet që në gjykimet rast pas rasti t’i japë prevalencë një dispozite karshi një tjetre, duke e bërë pastaj nul dispozitën e miratuar. Ajo, në të drejtën e saj, mund të gjykojë se parimi prevalon mbi rregullimin konkret që është bërë diku më poshtë. Edhe një herë, në fund të fare ne do të biem dakord për një tekst edhe për këtë nen dhe mund të jemi 100% korrektë, ose mund ta kemi edhe gabim. Kështu që ia vlen të shihet. Formulimi i Komisionit të Venecias është mjaftueshëm në favor të këtij diskutimi, sepse thotë “të paktën”. Le ta marrim në gjykim këtë çështje; flas për cenim të rëndë të parimeve dhe jo për gjë tjetër.



*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë, ka një gjë që duhet ta diskutojmë sot dhe duhet të jemi të qartë: gjërat që i ka vendosur qartazi Komisioni i Venecias dhe që nuk përbëjnë diskutim politik nuk janë më në këtë komision. Në qoftë se kjo do të shërbejë pastaj se ju doni të thoni “shiko, se ne kemi këtë apo atë”, mund të kemi shumë gjëra, por ne kemi vendosur një kornizë dhe përtej saj ne nuk diskutojmë. Në qoftë se kjo bëhet për disa qëllime të tjera, pra si ta zgjasim dhe si t’i vijmë vërdallë kësaj pune, kjo nuk është më pjesë e debatit në këtë komision.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, ne e duam “Venecian” të paktën sa e doni ju.

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk duam ne, e thotë Kushtetuta.

**Oerd Bylykbashi** – E interpretojmë Komisionin e Venecias të paktën po aq mirë sa ju.

**Fatmir Xhafaj** – E keni interpretuar në mënyrë të gabuar, kështu që i mbyllim këto diskutime.

**Oerd Bylykbashi** – Për çdo çështje që do të jetë e nevojshme për t’u rënë dakord, ne do të biem dakord, sepse është e domosdoshme kjo. Kështu që këtu nuk ka çështje jashtë axhendës sonë. Besoj se kjo është çështje e rëndësishme për t’u parë. Ne po diskutojmë; të mos e mbyllim derën. Ne mund të biem dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Për këtë gjë është mbyllur dera. Mos i bini kot kësaj dera.

**Oerd Bylykbashi** – Për mua nuk është. E shohim te menteshat.

**Fatmir Xhafaj** – Po, zoti Rainer.

**Rainer Deville** – Këtë e kemi diskutuar që prej një viti me ekspertët dhe Komisionin e Venecias. Unë mendoj se është mjaft mirë siç është e shkruar tani pasi të jep mundësinë që të shihet nëse dikush i ka keqpërdorur ndryshimet kushtetuese thjesht duke votuar me dy vota, prandaj kjo është në rregull. Ka pasur arsye të mira se përse kjo nuk është bërë ndryshe dhe është mjaft e qartë që nëse i merr të gjitha parimet bazë dhe parimi juaj bazë do të ishte neni 4, pika 2 e Kushtetutës, të ligjit më të lartë të Republikës së Shqipërisë. Në momentin që ju futeni në Bashkimin Evropian – ju tashmë e keni një problem kështu që nuk mund të futeni në Bashkimin Evropian dhe ka me qindra shembuj të tillë. Mos e bëni! Pra rrini aty ku jeni dhe është një debat i mençur shkencor dhe kjo është pikërisht ajo që u propozua nga Komisioni i Venecias. Mendoj që kjo është në rregull.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit! Vazhdojmë me nenin 22.

Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Neni 22, të nderuar anëtarë, nuk parashikon mundësi që Gjykata Kushtetuese të vendosë pezullimin e aktit që shqyrton deri në përfundimin e tij, pra është një diskrecion i saj, në rastet kur vijnë pasoja të rënda dhe të pariparueshme, ashtu siç është zhvilluar edhe doktrina dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, gjë që sot Gjykata Kushtetuese e bën sot me shumë kujdes, mjaft rrallë dhe e ka elaboruar. Gjithashtu, duket sikur nuk do të jetë e mundur që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të kenë fuqi prapavepruese në një nga rastet klasike të papajtueshmërisë së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kur çështjet janë në shqyrtim para një gjykate. Ligji e ka sot. Ne po flasim për një dispozitë të re dhe duhet të jemi të kujdesshëm. Dikush që e ka goditur më parë çështjen para një gjykate, por më pas baza ligjore, me të cilën është krijuar një pasojë që po kërkohet të zgjidhet nga gjykata është ende e pazgjidhur dhe gjykata vendos për pavlefshmërinë e bazës ligjore, sot me ligj është efekti prapaveprues. Ky është rasti klasik i prapaveprueshmërisë së një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera. Kështu që ne duhet t'i shohim këtu dy mundësi: atë të pezullimit kur shkaktohen dëme të pariparueshme dhe pasoja të rënda dhe atë të prapaveprueshmërisë, kur jemi përpara një çështje që është para gjykatës. Sigurisht që një formulim i përgjithshëm këtu dhe detajimi në ligj do të bënte punë, se nuk është e thënë ta shkruajmë të gjithën këtu, por duhet ta kemi këtë parasysh. Gjithashtu, duket sikur heqja e dispozitës aktuale, e cila parashikon që Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, pra nuk krijon normë pozitive gjykata, duket sikur në mënyrë implicite jep mundësinë për krijimin e një vendimi që krijon ligj. Kjo nuk duket të jetë e transpozuar në dispozita të tjera, por ekziston mundësia të keqinterpretohet. Pra, jemi duke lëvizur nga një themel që kemi deri më sot?! Kjo duhet të jetë e qartë.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, në Kushtetutën aktuale është thënë qartë se gjykata ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton. Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë ka dashur ta heqë këtë të drejtë të gjykatës? Pra, gjykata nuk ka më të drejtë ta shfuqizojë aktin, sepse, po të shikoni formulimin që i bëhet nenit të ri, në paragrafin e dytë të projektit të ndryshimeve kushtetuese thuhet vetëm çfarë do të bëjë gjykatë derisa vendimi të fillojë efektet dhe vendimet e gjykatës hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare?! Gjykata mund të urdhërojë që vendimi, me të cilin ka shqyrtuar aktet, të fillojë efektet në një datë tjetër dhe vetëm kur vendos që efektet do të fillojnë në një datë tjetër, ju parashikoni në ligj që gjykata mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të aktit të shfuqizuar prej saj ndaj kërkuesit në çështjet gjyqësore, por nuk

thuhet fare se çfarë do të bëhet me aktet që i ka quajtur antikushtetuese. A do t'i shfuqizojë, apo do t'i kërkojë organit që ka nxjerrë aktin ta shfuqizojë? Nuk e di nëse është harresë apo çfarë!

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Nisur nga shqetësimi i kolegëve, por duke parë edhe realitetin e zhvillimeve në përgjithësi, duke qenë se Gjykata Kushtetuese përgjithësisht vendimet i ka në raport me pushtetet e tjera zbatimi përfundimtar i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese gjithmonë ka hasur në rezistencë dhe në pikëpyetje. Çështja është si do ta definojmë zbatueshmërinë dhe konsekuencën e moszbatimit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

E ngrita si shqetësim për arsyen se nuk ka të bëjë me individin, aq sa ka të bëjë me pushtetin, por, duke qenë se ka të bëjë me pushtetin, përgjegjësia është pak më kolektive.

Shqetësimi i dytë që doja të ngrija, që është i njëjti që ka edhe Oerdi, i cili është sot edhe një nga debatet më të mëdha në SHBA, është që gjykata ka filluar dhe ka marrë një rol që i takon ligjvënësit. Domethënë, shpesh vendimet e Gjykatës së Lartë në SHBA (kjo ndodh edhe në vende të tjera, ne nuk duhet të krijojmë precedentë, është ndarja e pushteteve) kanë një forcë të tillë ligjore, madje ndërhyrjet kanë arritur në një pozicion të tillë. Ky është një debat dhe unë nuk mund të mbaj krah, por e rëndësishme në parimin e ndarjes së pushteteve është që legjislativi të jetë legjislativ dhe gjyqësori të jetë gjyqësor. Pra, të mos lëmë hapësirën të zëvendësojmë parlamentin me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky ishte shqetësimi im.

**Oerd Bylykbashi** – Po e mbyll me një fjalë këtë shqetësimin, të cilin e përmenda edhe në fillim, nëse ju kujtohet, pra marrëveshja politike e 24 dhjetorit 2014 dhe detyra që mori parlamenti i Shqipërisë, të cilën nuk e ka përmbyllur ende, është zbatimi sistematik i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, madje jo vetëm zbatimi, por edhe gjetja e një sistemi përmbarimor që cakton rregulla, afate dhe organe kompetente që marrin dhe e çojnë deri në fund. Rregullorja e Kuvendit e ka një instrument, Këshilli i Legjislacionit merr dhe shqyrton, sheh se cilat janë pasoja e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese dhe vepron: nxjerr legjislacion kur ka boshllëk, nxjerr legjislacion të ri kur është e nevojshme apo akte të tjera, por nuk jemi për qeverinë, për presidentin, për organet e pushtetit vendor, pra kemi një mungesë të një mekanizmi sistematik. Ligji i Gjykatës Kushtetuese ia jep kryetarit të Gjykatës Kushtetuese një gjë të tillë, por sot jemi përpara faktit që kemi një handikap. Duke nisur diçka këtu dhe duke e detajuar në ligj, mund të gjejmë një zgjidhje. Kjo ishte e para.

E dyta, janë dy probleme që lidhen me praktikitetin e zbatimit të vendimeve. Së pari, hyrja në fuqi, këtu rregullohet “Hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare”, por ne e dimë që Gjykata Kushtetuese vazhdimisht bën diçka: publikon dispozitivin dhe pret me muaj derisa ta zbardhë. A e ka ndarë mendjen që ky është përfundimi, apo thotë “hajde të gjejmë të gjithë arsyetimin e stërholluar juridik-kushtetues për ta mbështetur, apo çfarë”? Unë këtë nuk e di. Në fakt, krijohet një pritshmëri nga të gjithë personat e interesuar që madje mund të përfitojnë të drejta, apo edhe subjekte të tjera dhe jo vetëm individët. Por për fatin e tyre të keq, ta zëmë se është një çështje përpara gjykatës, të cilën ajo nuk e ka pezulluar; merr përfundimisht vendimin dhe e zgjidh sipas ligjit të vjetër dhe vendimi i gjykatës hyn në fuqi disa muaj më vonë. Pra, ne duhet të disiplinojmë kohën brenda të cilës nxirret vendimi i Gjykatës Kushtetuese; ta ndajë gjykata që, kur të dalë, të mos ketë situata të këtij lloji, pra të ketë një shtrëngim në këtë aspekt. Nëse do të bëhet këtu me një gjysmë fjale, apo do të bëhet në ligj, ky është një shqetësim që ne duhet ta trajtojmë patjetër.

E dyta, ka një debat në lidhje me mendimin e pakicës, që është një e drejtë e padiskutueshme. Mendimi i pakicës (nga ana tjetër, siç thuhet këtu, duhet bërë,) kur ekziston, duhet të jetë bashkë me vendimin e shumicës. Por, nëse pakica ka thjesht një votë pakice, por nuk ka shkruar mendim dhe nuk do të shkruajë, në mënyrë absolute kjo nuk mund ta mbajë të panxjerrë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Nëse nuk themi dot një gjysmë fjale më tepër këtu, ky duhet të jetë një shqetësim absolut për zgjidhjen në ligj, sepse mund të...

**Fatmir Xhafaj** – Po është në Kushtetutë... Neni 3, pika 3 është detyrues.

**Oerd Bylykbashi** – Edhe një herë: mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.

**Fatmir Xhafaj** – Nënkupton që është detyrues. Ka mbaruar. Nuk mund ta bëjë gjyqtari; është i detyruar, se duhet të zbatohet. Afatet janë çështje tjetër.

**Oerd Bylykbashi** – Më fal, po them këtë: Gjykata Kushtetuese, shumica ka marrë një vendim, por ekziston edhe një mendim pakice; është elaboruar edhe ky. Nëse Gjykata Kushtetuese nuk e publikon edhe këtë, këtu shkel Kushtetutën. Dakord?

**Fatmir Xhafaj** – Po, janë të detyruara ta shkruajnë, sepse mund të jenë tri mendime pakice.

**Oerd Bylykbashi** – Në qoftë se brenda një afati të caktuar, ata të pakicës nuk duan ta nxjerrin opinionin, kjo nuk mund ta mbajë peng vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kjo është më

e rëndësishme. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është më i rëndësishëm, opinionin le ta marrim vesh ne të tjerët, por nuk bën më shumë se opinion. Kështu që kjo duhet të rregullohet.

**Fatmir Xhafaj** – Por nuk mund të rregullohet në Kushtetutë. Mos e bëni ligj... Nuk jemi këtu për të gjykuar se çfarë përmbledh Gjykata Kushtetuese. I mban shënim kur të vijë ligji.

**Fatmir Mediu** – Që i themi, bëjmë mirë, sepse të paktën bëhemi më të mençur te paketa ligjore, por mendoj se ndoshta do të ishte më dobiprurëse që specialistët e të dyja palëve për *ëording* të uleshin, sepse mund ta gjejnë shumë më kollaj dhe ne procedojmë më shpejt.

**Fatmir Xhafaj** – Prandaj janë aty ata. Po mbajnë shënime ata.

**Fatmir Mediu** – Përpara se të vijmë ne, kemi shumë gjëra që kemi diskutuar për *wording*. Do të ishte mirë që specialistët e të dyja palëve për *wording*...

**Fatmir Xhafaj** – Cilat janë të dyja palët?

**Fatmir Mediu** – Mazhoranca dhe opozita.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk kemi ne.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Fatmir Mediu** – Këtu gjithmonë ka një gjë për t'u kapur me njëri-tjetrin. Ajo që them unë është se ne asistohemi nga disa teknicienë, edhe ju asistoheni nga disa teknikienë. Pashë se një mendimi i Pandit ishte në të njëjtën linjë me ne, për shkak se teknicienët kishin të njëjtin gjykim.

**Fatmir Xhafaj** – Pandi e kishte personale.

**Fatmir Mediu** – Ajo që po them edhe një herë: ka mundësi që *wording* të mos e bëjmë ne këtu, por edhe të mos e shtyjmë në kohë, pra ta bëjmë paraprakisht.

**Fatmir Xhafaj** – E di cili është problemi?! Ndërhyre për procedurë për një gjë që e kam thënë që në fillim të kësaj punë. Megjithatë, unë po e përsëris, sepse kam detyrimin ta përsëris, sepse prandaj jam këtu. Në fund fare, pasi të mbarojë e gjithë kjo, ne tani që po flasim, po kërkojmë njeriun i cili ka bërë korrigjimin gjuhësor të Kushtetutës të vitit 1998, i cili ka dalë në pension. Përveç kësaj, ekipi që është aty do të ndihmohet nga një ekip teknikësh që do të bëjnë harmonizimin e terminologjisë juridike, sepse ka shprehje të përkthyer nga anglishtja në shqip etj., etj., dhe bie dakord me ty.

**Fatmir Mediu** - E kisha fjalën pak më tepër se kaq.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për të gjetur jo vetëm shprehjen e përshtatshme, por edhe preokupimet që ne ngremë këtu. Mund të jenë të zgjidhshme që të mos humbasim kohë në nivel teknik. Ju, nëse doni ta bëni kështu, bëjeni.

**Fatmir Xhafaj** – Fjalën e ka zoti Rainer ose zoti Smibert.

**Jon Smibert** – Nuk do bëj historikun e Gjykatës së Lartë të SHBA-së, pavarësisht ftesës. Mendoj se ka dy aspekte lidhur me këtë çështje. Njëri aspekt është rasti se si Gjykata e Lartë e SHBA-së veprimi lidhur me reformën në sistemin e kujdesit shëndetësor. Vendimi është formuluar në mënyrë të tillë që i jep mundësinë sistemit tonë ta bëjë një gjë të tillë edhe pse një pjesë e madhe është shpallur jokushtetues dhe një aspekt i vogël nuk realizoi funksionimin e menjëhershëm të këtij akti, sepse do të kishte bërë që miliona njerëz të mbeteshin pa kujdes shëndetësor. Është strukturuar në mënyrë të tillë që të mund të pezullojë një efekt të tillë. Mendoj se qëllimi këtu është dhënia e mundësisë Gjykatës Kushtetuese të zbatojë vendimet e saj pa cenuar askënd.

Aspekti tjetër është mundësia për të shfuqizuar një akt apo riankimimi i një pjese të aktit në paragrafin 2. Nëse doni që kjo gjë të thuhet në mënyrë më të qartë, pra që Gjykata ka të drejtën e riankimimit dhe ka të drejtën ta vonojë këtë riankimim.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Besoj se jemi të qartë. Ndjesë, po z. Rainer.

**Rainer Deville** – Doja t’ju përgëzoja për këto diskutime. Mendoj se është me shumë vlerë që të vazhdojmë kështu pasi shohim çështjet për diskutim dhe mund të fokusohemi. Mendoj se kemi nxjerrë disa pika. Mbi njërin pikë do t’ju duhet që të paktën të merrni një vendim sot.

Lidhur me nenin 124, mendoj se edhe ju pajtoheni që në paragrafin 2 duhet të sqaroni rolin e Gjykatës Kushtetuese që do të jetë një organ që shqyrton vetëm çështjet ndaj argumenteve kushtetuese dhe që nuk vepron si një shkallë e katërt. Ky është njëri nga konkluzionet. Neni 125, pika 2, nëse doni ta ndryshoni nga 30 ditë në 6 javë duhet të vendosni ju. Nëse doni të hiqni në nenin 125, paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 jashtë ligjit zbatues dhe thjesht të lini fjalinë “gjyqtarët dhe kryetari i tyre do të sigurohen me anë të ligjit”.

Ju diskutuat për disa çështje të cilat nuk kanë ndryshuar ndonjëherë dhe kanë qenë pjesë e Kushtetutës origjinale dhe mendoj që ta lëmë ashtu siç është. Në nenin 127, pika 3, mendoj që referenca ndaj nenit 179, pika 1 mund të jetë tani pika 2 sepse e kemi rregulluar atë, kështu që ka

nevojë të kontrollohet. Në nenin 126 heqim fjalën “i paligjshëm”; në nenin 130, shtojmë komandimin. Mendoj se kemi rezultate shumë të mira.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Mbaruam me nenin 132, mendoj se për nenin 133 nuk kemi gjë.

**Pandeli Majko** - Te neni në fjalë, në pikën 2 propozoj që të shtohet në fund “Gjykata Kushtetuese merr vendimin përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, sipas rasteve të parashikuara me ligj”. Mendoj që në ligj, ne do të kemi trajtime specifike të mënyrës së votimit apo të krijimit të shumicave ku do të duhen në mënyrë specifike 5 vota për të marrë vendim apo në vazhdim ligji besoj do të jetë më specifik në këtë drejtim, prandaj nuk besoj se është e nevojshme që ta lemë pa shtuar sipas rasteve të përcaktuara me ligj, se mund të krijojë keqkuptime, dhe shumicat të reduktohen në rastet kur duhet të përcaktohen qartazi në ligj.

**Fatmir Mediu** – Shumica e të gjithë anëtarëve të saj, nuk mund të quhet shumicë, kur nuk janë prezent.

**Pandeli Majko** – Të jemi të qartë, duhet shtuar fraza referuese me ligj sepse në ligj do të parashikohet edhe rasti vetëpërrjashtimor, ku gjyqtari nuk do të votojë. Mendoj që duhet ta shikojmë kështu në ligj, ju lutem.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Majko, cili është rasti kur dalin barazim 4 me 4 që e tha Oerdi pak më parë? Ose është rasti kur ka konflikt interesi.

**Pandeli Majko**- Kur është rasti që nuk plotësohet numri i 5 votave, atëherë kërkesa do të quhet e rrëzuar.

**Fatmir Xhafaj** - Gjykata Kushtetuese gjermane, në mos gaboj, ndoshta Raineri ka dijeni dhe është këtu prezent, në rastin kur dalin 4 me 4, ligji nuk quhet i miratuar. Ose rasti i Gjykatës Kushtetuese të Austrisë, qofsha i gabuar, është që vota e kryetarit është dyshi. Ka modele të ndryshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

**Oerd Bylykbashi**- Përmenda çështjen e abstenimit. A do të ketë të drejtë të abstenojë një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, që na krijon probleme me shumicën? Di rastin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk mbaj mend kur ishte trup kushtetuese apo jo, që ishte i ndaluar abstenimi. Pra, anëtarët e KQZ-së shprehen me vendim. Besoj që ne duhet ta rregullojmë këtë pjesë. Vota e pavlefshme, që është një çudi, ta zëmë në rastin e votimeve për një individ, është

çudi në 9 veta, por në rastin konkret, abstenim me përjashtim të rasteve, kur ka konflikt interesi, duhet të abstenojë, heqim edhe kushtin e disiplinimit kur ai ka vendosur për interesa personale.

**Fatmir Xhafaj** –Rasti i disiplinimit është kur ai nuk e ka treguar dhe e ka bërë në mënyrë të qëllimshme.

**Oerd Bylykbashi** – Duhet rregulluar kjo pjesë. Kam edhe një çështje tjetër që duket e patrajtuar te ky nen.

Ka mbetur e pandryshuar nga ajo që i është dërguar për opinion final Komisionit të Venecias, dispozita ku ajo shprehet në paragrafin 46, në mos gaboj: “Rregullat procedurale në lidhje me pranueshmërinë e ankesave kushtetuese”, neni 133, pika 1, “Rregullat për formacionet gjyqësore që vendosin për pranueshmërinë, mund t’i lihen rregullimit të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese”, megjithatë Kushtetuta duhet ta përcaktojë këtë, përndryshe, duhet të kuptohet që çdo vendim duhet të merret gjithnjë nga Gjykata në procese gjyqësore.

Duket sikur ka nevojë për ta trajtuar. Ne kemi trajtuar vetëm pikën 2 me një ndryshim, ndoshta ky paragrafi 46 i Komisionit të Venecias duhet parë, siç thotë Komisionit të Venecias, për të bërë një shtesë.

**Pandeli Majko**- Pse nuk ta thotë goja që jam dakord me propozimin e zotit Majko?

**Fatmir Xhafaj** – A ka një opinion final që ta mbyllim?

**Rainer Deville** – Numri 46 e bën shumë të qartë. Ka vende të tjera ku kjo mund të rregullohet për të mos përcaktuar çdo gjë dhe çdo detaj në Kushtetutë. Ajo që Komisioni i Venecias sugjeroi të rregullohej ishte neni 46, fjalia e fundit ku thuhet se çdo vendim përfundimtar merret nga Gjykata Kushtetuese. Ky është neni i ri 133, pika 2. Kështu që ajo që nënkuptohet me këtë është që Gjykata Kushtetuese në veçanti duke shqyrtuar ankesat individuale mund të gjejë një numër substancial ankesash të papranueshme. Mund të rishikohet e të vendoset, pra të kalojë përmes një procesi filtrimi. Por pasi Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim përfundimtar duhet të vendosë me shumicën e të gjithë anëtarëve, që është 5 – pra kjo nënkuptohet me këtë aspekt. Kaq mjafton për Kushtetutën dhe ka reflektuar pikën 46 të Komisionit të Venecias.

**Vasilika Hysi** – Kam një pyetje për zotin Rainer. Në paragrafin e parë të nenit 133, ne nuk ndërhyjmë, por themi që “Pranimi i ankesës për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç e përcakton ligji”, pra jo nga e gjithë trupa prej 9 gjyqtarësh, por mund të jetë një numër më i vogël. Ky vendim që merret për të mos pranuar një ankesë, a do të quhet vendim përfundimtar



për gjykatën? Nëse do të quhet vendim përfundimtar, atëherë bie në kundërshtim me riformulimin që i bëjmë nenit kur themi që “Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve”, sepse në rastin e parë, refuzimi i kërkesës bëhet me një numër më të vogël gjyqtarësh që nuk është shumica, ose do të biem dakord të lemë riformulimin që bëri kolegu Majko, që t’i lemë ligjit rregullime të detajuara ose përjashtimore se si do të veprohet në rastet kur do të flitet për pranimin e ankesave dhe si do të veprohet në rastet kur Gjykata Kushtetuese do të marrë një vendim përfundimtar, pra e ka pranuar ankesën, e gjykon atë, dhe merr një vendim përfundimtar për të. Kjo është një pyetje që kam për zotin Rainer.

**Fatmir Xhafaj** – Ai është vendim i ndërmjetëm i treshes, e rrëzon, nuk e pranon në qoftë se ata bien të tre në konsensus, kështu është sot praktika e gjykimit në Gjykatën Kushtetuese. Në qoftë se 3-shja është dakord në një opinion që nuk do të shkojë në 9-she, atëherë nuk shkon në 9-she.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është shumicë, sepse është shumica e treshëve, e rregullon ligji këtë gjë. Paragrafet 1 dhe 2 janë dy gjëra të ndryshme. Njëri flet për kërkesat paraprake, pra për shqyrtimin dhe e dyta... po patjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Rainer Deville** – Ndoshta mund të qartësoni vendimet përfundimtare, sepse të tjerat për pranueshmëri i dallon Komisioni i Venecias, ku thuhet që 80% të çështjeve janë tërësisht të papranueshme. Ky ndoshta është një vendim përfundimtar për personin që ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk është dëgjuar, por ajo që nënkuptohet është vendimi përfundimtar. Prandaj, nëse e keqkuptoni vendimin përfundimtar, të tjerat janë vendime lidhur me pranueshmërinë dhe pasi shkoni në gjykatë merrni edhe vendimin lidhur me meritat e çështjes. Kështu që, nëse thjesht shtoni në nenin 133 “Vendim përfundimtar mbi meritat e çështjes së shqyrtuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të merret” do ta qartësonte.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Besoj se u sqaruam për nenin 133.

Vazhdojmë me nenin e fundit për sot, neni 24: “Neni 134 ndryshohet si më poshtë vijon”. A keni gjë?

Urdhëroni, zoti Mediu!

**Fatmir Mediu** - ...Presidenti, Kryeministri jo më pak se 1/5-ta e deputetëve”.

Për shembull, po marr rastin kur një deputet i pavarur do të ngrejë një çështje në raport me të drejtën e një ligji që ka kaluar, por kjo ia kufizon, sepse trupa parlamentare përbëhet nga grupe politike. Unë nuk e mendoj heqjen e të drejtës, qoftë edhe të një deputeti, për të ngritur një çështje. Pse duhet të bëhet me pesë dhe një deputet të mos e ketë këtë të drejtë? Sepse duket sikur i numërojmë deputetët si delet: 3, 5, 6 8.

Së pari, ai është një përfaqësues i drejtpërdrejtë atje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë e di që ka qenë, por po them se çfarë duhet të ndryshojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Fatmir Mediu** – Cili është risku që është një deputet nga pesë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Subjektet e parashikuara te germa “i” janë vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Pastaj kjo ka interpretim. Domethënë, ky është një deputet i zgjedhur dhe, në fund të fundit, ai ka një qëndrim në raport me një ligj, që e quan kushtetues ose jo kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** – Po të ishte ashtu, do të themi që edhe një ministër ka të drejtë, sepse mbulon një fushë të caktuar etj. Pastaj e hapim shumë gjykimin kushtetues.

**Fatmir Mediu** – Unë po flas për trupën parlamentare. Deputeti nuk është produkt i ministrit, ministri është produkt i deputetit. Unë nuk mendoj se gjithmonë 99% kanë të drejtë dhe 1% është në anën e gabuar, mund të ketë të drejtë edhe 1%-shi.

**Fatmir Xhafaj** – Është lënë një numër i kufizuar.

Për nenin nuk ka ndonjë gjë, kështu që le ta kalojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk pranohet, nuk kemi çfarë të bëjmë. Duhet të bësh 1/5-ën e deputetëve, ta fitosh në zgjedhjet që vijnë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Hapet shumë rrethi i subjekteve dhe Gjykata Kushtetuese...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në përmbyllje të gjithë kësaj, zoti Bylykbashi ka diçka.

**Oerd Bylykbashi** – Nuk e kam në përmbyllje, por do të them diçka që duhet ta shihnim te neni 17.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një nga kushtet për humbjen e funksionit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në momentin aktual është mos ushtrimi i detyrës për gjashtë muaj. Komisioni i Venecias thotë se nuk është e qartë arsyeja pse, sepse, në fakt, duket e arsyeshmja si kusht.

Besoj se kryetari ka diçka për të thënë në lidhje me ndonjë rast konkret ose jo, por në çdo rast mund të parashikohet një afat më i shkurtër sesa ky që është sot, por që do të ishte e arsyeshme të kishte një parashikim në lidhje me këtë.

**Fatmir Xhafaj** – Pse duhet t’i japim mundësi sot gjyqtarit apo kujtdo tjetër, kur këtë nuk kemi mundësi t’ia japim askujt në administratën shtetërore? Askush nuk mund të mungojë në punë pa arsye. Fillon procesi disiplinor nëse mungon pa arsye. Duhet të kesh një arsye objektive, që të jetë e justifikuar nga eprori, apo të jetë e justifikuar për arsye shëndetësore. Prandaj kanë dalë raportet.

Meqenëse dëshironi ta bëjmë më konkrete, atë që e thashë konfidencialisht, po e them edhe tani, le të e regjistrohet, kanë ndodhur praktika që në Gjykatën e Lartë dikush ka munguar pesë muaj, ka shkuar në Amerikë, është kthyer dhe më pas ka thënë që afatin e ka deri në gjashtë muaj për të mos ardhur në punë, dhe nuk ke çfarë të bësh. Kush mund ta bëjë këtë? Një nëpunës civil e bën dot këtë gjë?

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, po flasim për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese.

**Fatmir Xhafaj** – Po, më gjej një arsye pse. Kur e kanë vënë atëherë, kanë pasur parasysh që nuk do të ndodhnin këto gjëra famoze që kanë ndodhur nëpër gjykatat tona.

**Oerd Bylykbashi** – Sot, duke qenë prezent gjithë kohës aty, kanë të drejtë me ligj ta nxjerrin një vendim edhe pas iks kohësh nga momenti kur është mbyllur seanca e shqyrtimi në seancë. Unë nuk po them që afati 6-mujor është i arsyeshëm...

**Fatmir Xhafaj** – 3 muaj pse? Për çfarë arsyeje?

**Oerd Bylykbashi** – Një afat relativisht i gjatë, po themi, mund të parashikohet. Edhe Komisioni i Venecias e sheh si një arsye me vend për të qenë, 6 muaj apo 1 muaj është histori tjetër.

Sigurisht që bëjnë një diferencë këto shifra që thashë unë. 6 muaj, siç është sot, apo 1 muaj...

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një muaj mungon në gjykim. A e di se çfarë i ndodh trupës këtu? Janë lloj-lloj vështirësish.

**Oerd Bylykbashi** – Po flasim për Gjykatën Kushtetuese që e bën gjykimin me një seancë të vetme dhe...

**Fatmir Xhafaj** – Nxitojnë tani duke bërë gjyqe, sepse nuk plotësojnë shtatëshen pastaj.

**Oerd Bylykbashi** – Këto janë çështje rasti, nuk mund t'i...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk janë çështje rasti.

**Oerd Bylykbashi** – Ky ishte një shënim që unë doja ta kishim, nuk kam çështje tjetër.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

E mbyllim të gjithë gjykimin për këtë kapitull.

Nesër në orën 10:00 do të fillojmë me kapitullin për gjykatat.

Meqenëse zoti Rainer e bëri përmbledhjen, tha se po bëhej bashkëkryetar, është mësuar si i tillë dhe nuk i ndahet kësaj gjëje, unë nuk kam çfarë të bëj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nesër do të fillojmë në orën 11:00...

**Oerd Bylykbashi** – Nesër e kemi të pamundur, jemi të gjithë në axhenda të organizimeve në parti dhe nuk mundemi. Nesër në orën 11:00 nuk e zhvillojmë dot mbledhjen.

**Fatmir Xhafaj** – Kur doni ta bëjmë?

**Oerd Bylykbashi** – Ne fundjavën e kemi lënë për këtë gjë, nuk jemi.

**Fatmir Xhafaj** – Kemi bërë marrëveshje që do të punojmë deri...

**Oerd Bylykbashi** – Nuk është marrëveshje ajo. Siç ecëm sot, fillojmë edhe ditën e hënë. Ne nesër nuk jemi. Në fundjavë ne nuk jemi.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk fillojmë dot ditën e hënë, sepse kemi edhe Komision Ligjesh.

**Oerd Bylykbashi** – Në fundjavë ne nuk jemi. Domethënë, është një gjë që është vendosur dhe i kemi kalendarët të përcaktuar.

**Fatmir Xhafaj** – Mirë, mblidhemi sot pasdite në orën 18:00.

Kjo është shumë e rëndësishme për ne. Gjithsesi, ose sot pasdite në orën 18:00, ose nesër në orën 11:00 ne jemi këtu.

**Oerd Bylykbashi** – Do të komunikojmë më pas.

**Fatmir Xhafaj** – Janë nenet: 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe 34 për t'u shqyrtuar.

Faleminderit!

## **MBLEDHJA MBYLLET**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal.  
Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*